



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Menaxhim
Sistemesh Informacionit”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Adisa Daberdini

2. Dr. Eda Tabaku

Gusht/2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit me karakter profesional në “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti Ekonomise dhe Agobiznesit, Departamenti Informatikes dhe Matematikes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Menaxhim Sistemesh Informacioni
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr.246, date 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Nuk ka
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Diplome Profesionale
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Nuk ka
8	Cikli i studimit:	2 - vjeçare
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 simestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohe te plote
12	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	61
19	Komente / të tjera:	Për vitin akademik 2020-2021 nuk ka patur regjistrim të studentëve në këtë program studimi

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit me karakter profesional 2 vjecar “Menaxhim Sistemesh Informacioni” është hapur me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë përmes Urdhrit nr. 246 datë 19.07.2021 për “Hapjen e programit me karakter profesional Menaxhim Sistemesh Informacioni”. Ky program studimi zhvillohet në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, nën drejtimin e Departamentit të Matematikës-Informatikës.

GVJ konstaton që IAL “Universitetin Bujqësor të Tiranës” zotëron të gjithë kuadrin ligjor dhe strukturat drejtuese dhe mbështetëse për të garantuar një mirëfunksionim të programit të studimit.


GVJ konstaton që programi i studimit jouniversitar me karakter profesional në " Menaxhim Sistemesh Informacioni" është organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite në përputhje me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite akademike, 4 (kater) semestra dhe në total 120 kredite. Veprimtaria akademike e këtij programi ka filluar në vitin akademik 2021-2022.

GVJ konstaton se programi “Menaxhim Sistemesh Informacioni” nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara synon marrjen e njohurive në fushën e sistemeve të informacionit por edhe në fushën e ekonomisë dhe mjetet e nevojshme për praktiken e informatizimit.

GVJ konstaton se dosja e plotë të programit të studimit përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset.

GVJ konstaton se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi.

GVJ konstaton se veprimtaritë në këtë program mësimor konsistojnë në: Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (15%); – Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues të programit të studimit (65%); – Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese kredite (18%); – Veprimtari në disiplina të formimit plotësuese (17%); -- Detyrimet permbyllyse (5%).



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhër Nr 19, datë 20/02/2023 të ASCAL, "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit me karakter profesional 2 vjeçar "Menaxhim Sistemesh Informacioni", aplikuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve profesionale.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Institucioni, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit jouniversitar me karakter profesional në " Menaxhim Sistemesh Informacioni"

Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datën 16/03/2023 dhe 17/03/2023, në Institucionin e Arsimit të Lartë Universiteti Bujqësor i Tiranës sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriteve të standardeve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Ekspertët kanë hartuar edhe raportin bazuar në gjetjet dhe vizitën në institucion dhe kanë konkluduar vlerësimin e tyre duke dhënë edhe disa rekomandime të cilat janë reflektuar në fund të raportit bashkë me pikat e forta dhe të dobta të evidentuara në këtë proces.

Më datë 18.07.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 38/32 Prot., datë 18.07.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 21.07.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 35/4 Prot., datë 18.07.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardin III.5, Kriteri 7,**

GVJ: konstanton se akoma nuk ka të dilomuar në programin e studimit MSI dhe nuk ka patur akoma zhvillim të detyrimeve permbyllyse.

GVB: Programi i studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2020-2021. Duke qënë që është detyrim ligjor që studentët duhet të diplomohen mne një diplomë të akredituar, atëherë ky program iu nënshtrua procesit të akreditimit para diplomimit të brezit të parë të studentëve. Kjo është arsyeja që në periudhën kur është bërë raporti i vlerësimit të brendshëm Dhjetor 2022 - Janar 2023 akoma nuk kishte përfunduar viti i dytë i këtij cikli studimi, prandaj studentet nuk ishin diplomuar dhe pajisur me diplomën përkatëse. Diplomimi i brezit të parë të studentëve të programit Menaxhim Sistemesh Informacioni u zhvillua vetëm para një jave.

GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshon.

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.1, Kriteri 8

GVJ: GVJ konstaton se programi MSI është në vitin e dytë të tij ndaj nuk mundet dot të ekzaminojë një procedurë praktike profesionale.

GVB: Siç e kemi përmendur edhe më lart, ky program studimi është në brezin e parëtë studimeve dhe praktika profesionale nuk është zhvilluar në momentin e realizimit të raportit dhe vizitës së ekspertëve të jashtëm. Por theksojnë procedura e praktikës profesionale e studentëve të programit MSI kalon në të njëjtën proces ashtu siç zhvillohen të gjitha praktikat e studentëve të ciklit të parë Bachelor në fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit.

GVJ: Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në institucion, konstatimet dhe rekomandimet e lëna nga GVJ qëndrojnë dhe mbështeten dhe nga komenti/sqarimi i dhënë nga institucioni.

Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshon.

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.3, Kriteri 3,

GVJ: GVJ konstaton se Qendra e Alumnit dhe Kurrierës e ngritur në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka si qëllim mbështetjen dhe orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Programi i studimit MSI është në vitin e dytë të tij, prandaj dhe informacioni lidhur me këtë gjë është i vakët.

GVB: Konstatimi i GVJ-së është i drejtë dhe buron nga fakti që MSI ka filluar për herë të parë në vitin akademik 2020-2021. Përtëj këtij fakti gjithmonë nga departamenti dhe pedagogët e lëndëve përkatëse studentëve u janë transmetuar mundësitë ku mund të punësohen pasi të përfundojnë diplomimin e tyre.

GVJ: Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.3, Kriteri 3, GVJ (Vlerësohet fakti që departamenti dhe pedagogët e lëndëve u transmetojnë gjithmonë mundësi punësimi studentëve. Me qënë se programi MSI është në brezin e parë të studentëve të diplomuar, sikurse dhe Qendra e Alumni karrierës nuk ka të dhëna konkrete dhe GVJ nuk mund të arrijë në konkluzione.

Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshon.


4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.4, , Kriteri 4,

GVJ: Zyra e karrierës dhe Studentëve është përgjegjëse për mbajtjen e evidencave lidhur me fazën e përfundimit të studimeve. Por, duke qënë se brezi i parë i studentëve të programit MSI nuk është diplomuar akoma nuk ka akoma të dhëna.

GVB: Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) përmban evidencë në lidhje jo vetëm me studentët e programit Menaxhim Sistemesh Informacioni, por për të gjithë studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ky konstatim i grupit të vlerësimit të jashtëm është mëse llogjik dhe buron nga fakti që ky është brezi i parë i studentëve të këtij programi. Në lidhje me të gjitha konstatimet e bëra nga grupi i vlerësimit të jashtëm theksojmë se këto konstatime janë bërë edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm tek "Rekomandimet". E gjejmë me vend dhe mbështetje e nevojshme për mos u cënuar vlerësimi i programeve që akreditohen për herë të parë vetëm për efekt të maturimit në kohë, që ASCAL në të ardhmen mund të riformulojë kriteret që prekin pikërisht këto shqetësime.

GVJ: Vlerësohet fakti që ka ZSS e cila mban evidenca për të gjithë studentet e diplomuar, por me qënë se programi i studimit MSI është në brezin e parë të studentëve, nuk mund të arrijmë në konkluzione.


Raporti në këtë pikë nuk ka ndryshon.



Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Menaxhim Sistemesh Informacioni”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi L.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion programi i studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” i ofruar nga UBT është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe akteve ligjore në fuqi. Keto janë të shprehura dhe në rregulloren e studimeve universitare, në misionin vizionin dhe qëllimin e UBT. Këto janë shprehur dhe si pjesë e statutit të UBT në misionin e tij.</p> <p>Evidenca: Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF Dok 13. Statuti i UBT-se (neni 3).pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ofrohet në përputhje me misionin , vizionin dhe shtyllat kryesore të shprehur në nenin 3 në Statutin e UBT.</p> <p>Në statin e UBT është shprehur se këto programe synojnë të zhvillojnë programe formuese dhe trajnuese si edhe të realizojë shërbime arsimore, sociale dhe kulturore në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë kuader ai fron edhe programe studimi afatshkurtra për kualifikime dhe specializime ku përfshihet edhe programi i studimit i marrë në shqyrtim.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 3) Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Nga evidencat e paraqitura konstatojmë që programi i marrë në shqyrtim “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ofrohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Departamentin e Matematikë Informatikës. Konkretisht, ky program është konsideruar si aplikime të Informatikës në fushën e Ekonomisë dhe është në përputhje me fushën e drejtimit të departamentit dhe të fakultetit. Departamenti i Matematikë Informatikës ka gjithashtu në përbërjen e tij një staf të kualifikuar i cili mbart eksperiencë dhe është në përputhje me fushën e programit të studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni”. Për vitin akademik 2021-2022 ky departament ka angazhuar në këtë program studimi 9 pedagogë PAE (2 Prof.Asoc, 5 Dr. 2 MSc.) dhe 1 pedagogë PAK (1 MSc.), ndërsa aktualisht për këtë vit akademik është angazhuar një staf akademik përkatësisht 12 PAE (2 Prof.Dr, 3</p>



	<p>Prof.Asoc. 5 Dr. 2 MSc) dhe 3 PAK (2 Dr, 1 Msc.)</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF</p> <p>Dok 70. Tabela 6 - Stafit akademik per programin MSI.pdf</p> <p>Dok 66. Tabela 2 - Stafit akademik i departamentit Matematike - Informatike.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një studim të mirëfilltë tregu në momentin e aplikimit për hapjen e tij. Në këtë studim janë bërë hulumtime të mjedisit të jashtëm global dhe kërkesave në nivel kombëtar në lidhje me fushën e sistemeve të menaxhimit të informacionit në fushën e ekonomisë. Studimi është bazuar edhe në të dhënat e marra nga INSTAT në 2020 mbi përdorimin e kompjuterit në kompani ose në ndërmarrje të fushës së ekonomisë. Gjithashtu në studim janë paraqitur fushat ku mund të punësohet studentet. Nga 2020 UBT dhe Departamenti i Matematikës dhe Informatikës nuk ka ndërmarrë studime të mëtejshme tregu për këtë program.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Dok 18. Analiza e tregut të punës (MSI).PDF</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstanton se UBT i disponon të gjitha kapacitetet dhe përvojën e nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit përbëhet nga dy godina, 14 salla leksionesh, 26 salla seminaresh, 10 laboratorë, ambientet në dispozicion të stafit dhe studentëve dhe biblioteka etj. Këto infrastrukture janë në dispozicion të procesit mësimor të të gjithëprogrameve përfshirë këtu dhe programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni”.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit aktualisht ka 6 departamente, 21 programe studimi (2 profesional 2-vjeçar, 6 Bachelor, 2 master profesional, 5 Master i Shkencave, 1 Master Ekzekutive dhe një Doktoraturë), 89 pedagogë efektive dhe 71 pedagogë të ftuar.</p> <p>Në programin e studimit “Menaxhim sistemesh Informacioni” japin mesim 15 pedagogë me tituj, ku 5 janë profesorë, 7 janë Doktor Shkencash dhe 3 Master i Shkencave.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF</p> <p>Dok 20. Infrastruktura akademike në funksion të MSI.PDF</p> <p>Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF</p> <p>Dok 67. Tabela 3 - Programet e studimit të ciklit I, II dhe III në FEA.pdf</p> <p>Dok 66. Tabela 2 - Stafit akademik i departamentit Matematike - Informatike.pdf</p> <p>Dok 21. Pedagoget e Ftuar në FEA për Vitin Akademik 2022-2023.PDF</p> <p>Dok 22. CV-të e stafit akademik të programit MSI.pdf</p>

<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit “Menaxhim Sistemesh Informacionit” ofrohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit i cili në përbërjen e tij ka 6 departamente. Nga evidencat e paraqitura konstatojmë që programi i marrë në shqyrtim organizohet nga Departamenti i Matematikë Informatikës dhe është vijim i programeve që ky departament ndërmerr në fushën e informatikës, sistemeve të informacionit, teknologjive web dhe fushën e përgjithshme të FEA që është ekonomia bujqësore.</p> <p>Programi i studimit “Menaxhim Sistemesh Informacionit” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore specifike të departamentit të matematikës dhe informatikës.</p> <p>Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstanton që standarti 1.1 përmbushet plotësisht. Nga evidencat e paraqitura konstatojmë që programi i marrë në shqyrtim “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ofrohet në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Departamentin e Matematikë Informatikës. Konkretisht, ky program është konsideruar si aplikime të Informatikës në fushën e Ekonomisë dhe këto janë në përputhje me fushën e drejtimit të departamentit dhe të fakultetit. GVJ konstanton se UBT duke qënë dhe Universitet publik i disponon të gjitha kapacitetet dhe përvojën e nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni UBT ka një strukturë të qartë organizative dhe institucionale ku detyrat dhe përgjegjësitë janë të mirëpërcaktuar në Statut dhe në Rregullore të Universitetit. Mbarëvatja dhe supervizimi i programit të studimit bëhet nga Departamenti i Matematikës dhe Informatikës i cili funksionon mbi bazën e një rregullore të qarte dhe funksionale. GVJ konstaton një angazhim të stafit akademik në departamente të tjera duke sjellë një frymë bashkëpunimi dhe risie. Bashkëpunimet janë të vazhdueshme dhe me njësitë administrative si Sekretaria Mësimore, NJSBC, Zyra e Karrierës & Alumni, biblioteka, Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerezore etj.</p> <p>Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF</p>

	<p>Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF</p> <p>Dok 23. Analiza veprimtarise mesimore dhe kerkimore , DMI 2021-2022.PDF</p> <p>Dok 24. Analiza e veprimtarise mesimore, kerkimore dhe i marredhenieve me publikun _ institucionet (FEA) 2021-2022.PDF</p>									
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UBT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të biznesit dhe institucione shtetërore në drejtim të zhvillimit të praktikave profesionale, trajnimit dhe aftesimit më të mirë të studentëve. Kualifikimi i stafit dhe i studentëve është paraqitur si prioritet dhe në planin strategjik të universitetit. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga vizita ne UBT cdo vit stafi akademik dhe studentet janë bërë pjesë e programeve të shkëmbimit si Erasmus+, CËPUS, marrveshje me GIZ etj. UBT në dokumentacion ka paraqitur që ka marrveshje në institucione të ndryshme brenda dhe jashte vendit. Institucioni ka paraqitur dhe një dokument për trajnimet e studentëve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit.</p> <p>GVJ rekomandon qe shikohet mundesia per bashkepunime me institucione te tjera ndërkombëtare qe kane programe studimi te ngjashme qe kane projekte ne Erasmuss+ ose te tjera dhe të përfshihen dhe studentët e profilit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” në UBT.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 17. Plani Strategjik i UBT-se 2016-2025.pdf</p> <p>Dok 25. Raport i Bashkepunimit Institucional brenda dhe jashte vendit, UBT.PDF</p> <p>Dok 26. Zyra Erasmus, UBT.PDF</p> <p>Dok 27. Trajnimet e Studenteve te FEA.PDF</p>									
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni”, GVJ konstanton që institucioni ka paraqitur marrvëshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi dhe gjithashtu dhe të gjithë fakultetit FEA. Në analizën e tregut të punës janë paraqitur dhe institucionet me të cilat UBT ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave të programit të studimit të cilin e kemi në shqyrtim. Disa prej kompanive që janë paraqitur ne liste janë dhe këto që kemi paraqitur më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="683 1473 1177 1749"> <tr><td>Kompania “Gjelberimi 2000” shpk</td></tr> <tr><td>Kompania “Loren” SHPK</td></tr> <tr><td>Instituti i Sigurimeve Shoqerore (ISSH)</td></tr> <tr><td>Kompania “Subashi”shpk</td></tr> <tr><td>Kompania “EMKO”shpk</td></tr> <tr><td>Kompania “Mare Adriatik”shpk</td></tr> <tr><td>Kompania “Ildrag”SHPK</td></tr> <tr><td>Kompania “Beta Mobileri”shpk</td></tr> <tr><td>Kompania “Shaga”shpk</td></tr> </table> <p>Studentët mund të përdorin dhe një platform GRADUA që u lejon që të kenë mundësi kontakti me tregun e punës. Mund të rregjistrohen dhe të krijojnë CV e tyre dhe u bëhet dhe një pyetësor mbi zhvillimin e praktikave.</p>	Kompania “Gjelberimi 2000” shpk	Kompania “Loren” SHPK	Instituti i Sigurimeve Shoqerore (ISSH)	Kompania “Subashi”shpk	Kompania “EMKO”shpk	Kompania “Mare Adriatik”shpk	Kompania “Ildrag”SHPK	Kompania “Beta Mobileri”shpk	Kompania “Shaga”shpk
Kompania “Gjelberimi 2000” shpk										
Kompania “Loren” SHPK										
Instituti i Sigurimeve Shoqerore (ISSH)										
Kompania “Subashi”shpk										
Kompania “EMKO”shpk										
Kompania “Mare Adriatik”shpk										
Kompania “Ildrag”SHPK										
Kompania “Beta Mobileri”shpk										
Kompania “Shaga”shpk										

	<p>GVJ konstanton që institucioni nuk ka paraqitur shumë kompani që janë të fushës së teknologjisë së informacionit ku studentët e MSI mund të merrnin njohuri të mirefillta në praktikat e tyre.</p> <p>GVJ rekomandon me shume marrveshje bashkepunimi me kompani që operojne ne fushen e teknologjise se informacionit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF</p> <p>Dok 25. Raport i Bashkepunimit Institucional brenda dhe jashte vendit, UBT.PDF</p> <p>Dok 61. Raporti GRADUA.PDF</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton hartimin e një raporti në lidhje me bashkëpunimet në fushën e biznesit dhe institucioneve homologe. Bashkëpunimi me kompanitë për zhvillimin e praktikave për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” është paraqitur i listuar dhe tek analiza e tregut të punës që është paraqitur për hapjen e këtij programi. Gjithashtu ne nivel të njësisë qëndrore Fakulteti Ekonomise dhe Agrobiznesit ku ndodhet dhe programi i studimit ka paraqitur dhe raport të evidencave të përvitshme të përfitimeve nga marrveshjet profesionale të realizuara nga studentet.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF</p> <p>Dok 25. Raport i Bashkepunimit Institucional brenda dhe jashte vendit, UBT.PDF</p> <p>Dok 27. Trajnimet e Studenteve te FEA.PDF</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga UBT dhe nga vizita në institucion, GVJ konstanton se institucioni ka mbështetur studentët e vet për praktikat dhe për punësimin e mëtejshëm në kompanitë me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi. Institucioni UBT ka paraqitur një listë të kompanive me të cilat ka marrveshje për zhvillimin e praktikave të këtij programi studimi. Si mundësi shumë e mirë për praktikat është paraqitur dhe Panairi i Karrierës që UBT organizon me bizneset dhe organizatat e ndryshme.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF</p> <p>Dok 28. Performanca e QKA 2019-2020.PDF</p> <p>Dok 29. Raport vleresimi, Panairi i Karrieres 2022.PDF</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni UBT ka një strukturë të qartë organizative dhe institucionale ku detyrat dhe përgjegjësitë janë të mirëpërcaktuar në Statut dhe në Rregulloret të Universitetit. Mbarëvatja dhe supervizimi i programit të studimit bëhet nga Departamenti i Matematikës dhe Informatikës i cili funksionon mbi bazën e një rregullore të qartë dhe funksionale. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga UBT dhe nga vizita në institucion, GVJ konstanton se institucioni ka mbështetur studentet e vet për praktikat dhe për punësimin e mëtejshëm në kompanitë me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi.</p> <p>GVJ konstanton që institucioni nuk ka marrveshje bashkëpunimi me kompani që operojne ne fushën e teknologjisë së informacionit ku studentët e MSI mund të merrnin njohuri të</p>

	<p>mirefillta në praktikat e tyre.</p> <p>GVJ rekomandon qe IAL të këtë me shumë marrveshje bashkëpunimi me kompani që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit në mënyre që studentët të kenë mundësi praktike më të mira.</p> <p>GVJ rekomandon qe shikohet mundësia për bashkëpunime me institucione të tjera ndërkombëtare që kanë programe studimi të ngjashme, që kanë projekte në Erasmuss+ ose të tjera dhe të përfshihen dhe studentët e profilit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” në UBT.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstanton gjithashtu nga dokumentacionet e dorëzuara se Insitucioni UBT ka politika dhe rregullore për sigurimin e cilësisë dhe mbarevajtjen e vetë programit të studimit konform dhe legjislacioneve në fuqi. Këto janë paraqitur gjithashtu dhe në rregulloren. Institucioni UBT ka paraqitur që ka njësi të veçantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilesise. E cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitetet e UBT. Këto janë paraqitur dhe në statutin e UBT, kreu 9, neni 83 “Organizimi Strukturalor i Sigurimit të Cilësisë i UBT”.</p> <p>Hapja dhe funksionimi i njësisë DVBSK e cila mbështet në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, statutin e UBT, rregulloren e studimeve në UBT.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 83) Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që ka njësi të vecantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Kjo drejtori është e përbërë nga dy sektore; nga sektori i programeve dhe i kurrikulave dhe nga sektori i sigurimit të cilësisë. Në përbërje të organizimit të kësaj drejtorie kemi drejtorin e drejtorisë, përgjegjësi për sektorin e programeve dhe kurrikulave, përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe një specialist. Kjo drejtori për mbarevajtjen e punës së saj dhe sigurimin e cilësisë bashkëpunon me të gjitha njësitë e tjera përgjegjëse dhe për programin e studimit MSI që kemi në shqyrtim, zyrën e Studimeve dhe të</p>

	<p>Studenteve etj. Gjithshtu bashkëpunon me ekspertët e ASCAL dhe të MAS. Kjo paraqitet dhe në nenin 9 të rregullores së vlerësimit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Evidenca: Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB dhe nga vizita në insitucion, GVJ konstanton se institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për vlerësimin e cilësisë në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL-it. Këto janë paraqitur dhe në statutin e UBT në nenin 86.</p> <p>Institucioni UBT ka kryer akreditimin institucional në vitin 2021 dhe ka marr një vlefshmeri të akreditimit deri në vitin 2026.</p> <p>Kurse programi Menaxhim Sistemes Informacioni është hapur në vitin 2021 sipas urdhërit të MAS të paraqitur dhe në dokumentacionin e dorëzuar.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 86) Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf Dok 6. Urdheri i hapjes se programit MSI nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.pdf Dok 7. Vendimi i Ascalit per akreditimin e UBT-se.PDF Dok 8. Certifikata e akreditimit te UBT-se.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur se përdor tregues të ndryshëm për vlerësimin e qartë të gjendjes së programit të studimit, arritjeve dhe dobësive të cilat janë paraqitur dhe në statutin e UBT. Këto tregues të qartë vijnë nga marrëveshjet e shumta që ka me bizneset dhe nga gjurmimi i qendrave Alumni. E njëjta gjë është paraqitur të zhvillohet dhe për studentet e programit MSI që kemi në shqyrtim pasi aktualisht studentët e këtij programi janë në vitin e dytë. Tregues tjetër janë rezultatet e provimeve, opinion studentëve në Senatën akademik etj. Kurse tregues për vlerësimin e kërkimit shkencor është analiza e veprimtarisë shkencore e bërë nga anëtarët e departamentit të Matematikë Informatikës e cila është paraqitur dhe në dokumentacion.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 14) Dok 25. Raport i Bashkepunimit Institucional brenda dhe jashte vendit, UBT.PDF Dok 23. Analiza veprimtarise mesimore dhe kerkimore , DMI 2021-2022.PDF Dok 24. Analiza e veprimtarise mesimore, kerkimore dhe i marredhenieve me publikun _ institucionet (FEA) 2021-2022.PDF Dok 31. Raport Gjurmimi i Studenteve ne UBT.PDF</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që ka njësi të vecantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E cila është përgjegjëse për</p>

	përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitetet e UBT. Institucioni UBT ka paraqitur se përdor tregues të ndryshëm për vlerësimin e qartë të gjendjes së programit të studimit, arritjeve dhe dobësive të cilat janë paraqitur dhe në statutin e UBT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur GVJ kontanton që programi i studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni është i organizuar në lëndë dhe module. Ky program ka një kohezgjatje 2 vite akademike, i ndarë në 4 simestre. Në dokumentacion janë paraqitur syllabuset e përditesuar të lëndëve. Programi i studimit është i organizuar në module të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit i përket nivelit të 5 në kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe VKM Nr.41 datë 18.12.2019 “Mbi elementet e programit të studimit të ofruar nga institucionet e Arsimit të lartë”. Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit të studimit MSI.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara për programin MSI.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e	Programi i studimit ofron formimin e profesionistëve në fushën e teknologjisë së informacionit. Këto janë shprehur dhe në përshkrimin e programit të studimit sipas të cilit synohet edukimi i profesionistëve në fushën e teknologjisë web, shërbimeve grafike dhe mbështetjeve të IT. Studentët do të jenë të aftë për të ndërtuar aplikacione web-i, të përpunojnë imazhe ose të ndërtojnë paraqitje grafike etj. Bazuar në syllabuset që janë dorëzuar dhe në programin e lëndëve janë përfshirë lëndë si: sistemet e shfrytëzimit, programim në web, bazat hardware, data vizualizim, PHP&My SQL, wordpress Adobe Illustrator & Design etj. të cilat janë lëndë bashkëkohore në fushën e IT dhe me

<p>problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>zbatim të gjerë në institucione ose në kompani private. Evidenca: Dok 33. Pershkrimi i programit MSI.PDF Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf</p>																								
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit MSI i UBT i ka të përcaktuara qartë objektivat e formimit profesional të studentëve në të cilat janë përfshirë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të përfitojnë studentët. GVJ konstanton që këto objektiva janë të paraqitura dhe në rregulloren e programit të studimit MSI, në syllabuset e secilës lëndë të ofruar në këtë program studimit. Institucioni ka paraqitur në dokumentacion si qëllime bazë të këtij programi studimi këto: formimi profesional dhe i kualifikimit të studentëve në fushën e informatikës, sistemeve të informacionit etj; përgatitja e profesionisteve për zgjidhjet praktike të problemeve të IT; ndërtimi i niveleve të njohurive që të jenë të krahasueshme me diplomat dhe të universiteteve jashtë vendit etj. Evidenca: Dok 33. Pershkrimi i programit MSI.PDF Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf</p>																								
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga RVB konstantojmë që programi i studimit e ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/ modulet duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimet përmbyllëse të këtij programi studimi. Detyrimi përmbyllës i këtij programi studimi MSI është provimi i formimit. Ky program është organizuar në bazë të komponenteve të mëposhtëm të cilët janë shprehur dhe në kredite.</p> <table border="1" data-bbox="611 1238 1353 1783"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>IAL (kredite ne %)</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>12.5%</td> <td>10-15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>54.16 %</td> <td>45- 55 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>15 %</td> <td>5-15% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese</td> <td>14.17 %</td> <td>10 – 15 % (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse</td> <td>4.17%</td> <td>3 – 5 % (kredite)</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në programin e studimit me karakter profesional praktika profesionale është pjesë përbërëse e kurrikulës dhe vleresohet me 12 ECTS,</p>	Kategoria	Tipi	IAL (kredite ne %)	Standardi	A	Lëndë Bazë	12.5%	10-15 % (kredite)	B	Lëndë karakterizuese	54.16 %	45- 55 % (kredite)	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	15 %	5-15% (kredite)	D	Lëndë plotësuese	14.17 %	10 – 15 % (kredite)	E	Detyrime përmbyllëse	4.17%	3 – 5 % (kredite)
Kategoria	Tipi	IAL (kredite ne %)	Standardi																						
A	Lëndë Bazë	12.5%	10-15 % (kredite)																						
B	Lëndë karakterizuese	54.16 %	45- 55 % (kredite)																						
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	15 %	5-15% (kredite)																						
D	Lëndë plotësuese	14.17 %	10 – 15 % (kredite)																						
E	Detyrime përmbyllëse	4.17%	3 – 5 % (kredite)																						

	<p>pasqyrohet si lëndë plotësuese e karakterit D në simestrin e katërt. Si përmbyllje e programit të studimit MSI studentet realizojnë një provim formimi përfundimtar i cili vlerësohet me 5 ECTS dhe realizohet në fund të simestrit të katërt.</p> <p>GVJ konstantoi që përmbushet shpërndarja e krediteve sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, kategorive të përcaktuara edhe në rregulloren e programit mësimor dhe ndarjes së tyre në këtë program.</p> <p>Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara për programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar konstanton që pranimi, organizimi dhe financimi i studentëve me status të veçantë në UBT realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse në kuadrin ligjor përkatës të ministrisë. Institucioni UBT ka ndërtuar infrastrukture mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta. Në këtë vit akademik 2022-2023 janë regjistruar tre student që i përkasin kategorive të veçanta dhe njeri është në programin MSI që kemi në shqyrtim. Bazuar në VKM 269, datë 29.03.2017 studentet me status të veçantë përjashtohen nga tarifa e shkollimit.</p> <p>Evidenca: Dok 34. Lista e studentëve të regjistruar me kuota sipas kategorive të veçanta.PDF</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni UBT, nuk kemi të paraqitur program të njëjtë studimi me të njëjtën ngarkesë si programi Menaxhim Sistemesh Informacioni. Kjo mund të shikohet dhe në programet profesionale që UBT ofron.</p> <p>Evidenca: https://www.ubt.edu.al/fea (programet e studimit)</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që programi i studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni duke qënë se ka filluar në vitin akademik 2021-2022 nuk ka akoma një kod përkatës të këtij programi.</p> <p>Megjithatë programi i studimit është i ndarë në module, orë fizike për çdo modul të ndara sipas leksioneve dhe seminareve, përdagogët përkatës që mbulojnë modulin, kreditet dhe kategorizimin e lëndëve.</p> <p>Evidenca: Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 6. Urdhri i hapjes së programit MSI nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.pdf Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 5,6)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga RVB konstantojmë që programi i studimit e ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/ modulet duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimet përmblyëse të këtij programi studimi. GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar konstanton që pranimi, organizimi dhe financimi i studentëve me status të veçantë në UBT realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse në kuadrin ligjor përkatës të ministrisë.</p>

	GVJ konstantoi që përmbushet shpërndarja e krediteve sipas kategorive të përcaktuar në VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, kategorive të përcaktuar edhe në rregulloren e programit mësimor dhe ndarjes së tyre në këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X


Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB, njësia bazë qendrore për këtë program studimi është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, i cili në përbërje ka dhe departamentin e Matematikës dhe Informatikës. Sipas rregullores së FEA-s të paraqitur, ky fakultet ka për detyrë të përmbushë detyrimet e përcaktuara në legjislacionet në fuqi për organizimin e strukturës akademike, stafin akademik, vlerësimin dhe akreditimin. FEA bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor, miraton kriteret e pranimit të studentëve etj. FEA dhe Departamenti Matematik Informatikës ka në përbërje të tij staf të kualifikuar dhe specialist të fushave të ndryshme që janë përcaktuar në statutin e UBT-së. FEA ka në përbërjen e tij 89 pedagoge efektive ku 45 janë të kategorisë “Profesor”, 32 janë “Doktor Shkencash”, 12 janë “Master i Shkencave”. Departamenti Matematikës dhe Informatikës ka në përbërjen e tij 20 pedagoge me kohe të plotë ku 7 janë të kategorisë “Profesor”, 8 janë “Doktor Shkencash” dhe 5 janë “Master i Shkencave”.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik departamenti në përputhje me kurrikulat e programeve harton planin mësimor ku përfshihet dhe plani mësimor i MSI, ngarkesa vjetore e cila miratohet nga dekani i FEA-s.</p> <p>Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 5,6) Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf Dok 65. Tabela 1- Stafit akademik sipas departamenteve të FEA-s.pdf Dok 66. Tabela 2 - Stafit akademik i departamentit Matematike - Informatike.pdf Dok 35. Plani mesimor i programit të studimit MSI (Kursi i parë dhe Kursi i dytë).pdf Dok 36. Ngarkesa mesimore e DMI 2022-2023 (plan).pdf</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke	Institucioni UBT dhe njësitë e veta kryesore për programin e studimit MSI që janë Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe Departamenti i Matematik Informatikës i përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionet në fuqi. Në përbërje të këtyre njësive ka

angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>staf akademik dhe personel ndihmës akademik/administrative. Personeli ndihmës akademik është në shërbim të vazhdueshëm për krijimin e kushteve për realizimin e planit mësimor dhe praktikave. Ky personel kryen veprimtari këshillimi për studentët, veprimtari administrative në funksion të realizimit të objektivave të programit. Këto struktura paraqiten dhe në statutin e UBT, neni 46 dhe 22.</p> <p>Evidenca: Dok 65. Tabela 1- Staf akademik sipas departamenteve të FEA-s.pdf Dok 66. Tabela 2 - Staf akademik i departamentit Matematikë - Informatikë.pdf Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 46)</p>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Institucioni UBT dhe njësia kryesore për këtë program studimi Menaxhim sistemesh informacioni që është Fakulteti I Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe Departamenti Matematikë Informatikës ka në përbërje të tij një staf akademik i kategorisë profesor i cili është në funksionin e koordinorit për këtë program studimi. Ky personel akademik është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 22)</p>			
Konkluzione	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB, Njësia bazë qendrorë për këtë program studimi është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, i cili në përbërje ka dhe departamentin e Matematikë Informatikës. Sipas rregullores së FEA-s të paraqitur, ky fakultet ka për detyrë të përmbushë detyrimet e përcaktuara në legjislacionet në fuqi për organizimin e strukturës akademike, stafin akademik, vlerësimin dhe akreditimin.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Programi Menaxhim Sistemesh Informacioni si njësi bazë kryesore ka Departamentin e Matematikë Informatikës. Njësia kryesore e disponon informacionin e nevojshëm për organizimi, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të cilat përditesohen për çdo vit akademik. Këto janë të evidentuara dhe në dokumentacionet e dorëzuara nga RVB të cilat janë plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit, kurrikulat e programit të studimit etj.</p> <p>Evidenca:</p>



	<p>Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf Dok 70. Tabela 6 - Stafii akademik per programin MSI.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar programi MSI përmban planin mësimor për kursin e parë dhe të dytë. Në planin mësimor është i përfshirë i gjithë informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në simestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor dhe jashtë auditori. Programi MSI i përket nivelit të 5 të kornizës Shqipëtare të kualifikimeve. Ai është i ndarë në 2 vite akademike me kohë të plotë, 4 simestre dhe 120 kredite në total. Këto pasqyrohen dhe në kurrikulën e programit dhe në planin mësimor. Këtu jepet informacion i detajuar mbi veprimtaritë formuese të programit të studimit, komponentët mësimor, orët në auditor, mënyrës se kontrollit të dijeve, praktikës profesionale dhe diplomimit. Me poshte janë dhe evidencat e planit mësimor të MSI dhe gjithashtu evidencat mbështetëse për strukturën e programit.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstanton që programi i studimit MSI i përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët të cilat lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimet dhe ekuivalentimit të studimeve. Pranimi i studenteve në programin MSI bëhen në bazë të legjislacionit në fuqi nga MAS, bazuar në rregulloren e studimeve universitare të UBT-së dhe në bazë të kriterëve të pranimit të përcaktuara në këtë program studimi që propozohen dhe miratohen çdo vit nga organet drejtuese të FEA dhe UBT-së. Në programin e studimit MSI pranohen të gjithë studentet që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional.</p> <p>Institucioni UBT ka dorëzuar në dokumentacion propozimin për përgjedhjen e kandidatëve për kriteret e pranimit të studentëve të rinj të FEA ku përfshihen dhe studentët e këtij programi. Gjithashtu në rregulloren e programit dhe në rregulloren e FEA janë paraqitur procedurat për transferim dhe ekuivalentim të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MAS.</p> <p>Informacionet për kriteret, aplikimin dhe transferimet janë të publikuara dhe në faqen e web-it të UBT.</p> <p>Evidenca: Dok 38. Propozimi i kriterëve per pranimin e studenteve te rinj tek FEA, 2023-2024.PDF</p>

	<p>Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF (nenet 75-78)</p> <p>Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF</p> <p>https://www.ubt.edu.al/njofitime-per-studentet</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni UBT konstantojmë që për programi e studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni janë paraqitur të gjitha informacionet e nevojshme lëndore. Në dokumentacion janë syllabuset për secilin modul, Kurrikula, plani mësimor, ngarkësa e plotë e stafit akademik dhe struktura e vitit akademik etj.</p> <p>Syllabuset e dorëzuara janë të hartuara në bazë të VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Në syllabuse përfshihen informacionet për titullin e modulit, titullarin e lëndës, kreditet e lëndës, simestrin dhe vitin akademik, ngarkesa në orë, cikli studimit, karakteri modulit, temat e lëndës, literatura e nevojshme dhe plotësuese etj. Sipas Rregullores së FEA është paraqitur që syllabuset hartohen nga titullari modulit, shqyrtohen në departament, dhe miratohen nga dekani i fakultetit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf</p> <p>Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf</p> <p>Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf</p> <p>Dok 36. Ngarkesa mesimore e DMI 2022-2023 (plan).pdf</p> <p>Dok 39. Struktura akademike, DMI - 2022-2023.pdf</p> <p>Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF (neni 55)</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në shqyrtim, në rregulloren e programit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit në fillim të çdo viti akademik kryhen rishikimet e çdo programi dhe të programit Menaxhim Sistemesh Informacioni. Përmirësime ose ndryshime bëhen lidhur me literaturën e përdorur, raporti leksion/seminar, numri krediteve, forma e kontrollit të dijeve etj. këto ndryshime më pas arkivohen me dosjen e programit në departament.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF (neni 93)</p> <p>Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf</p> <p>Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf</p> <p>Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi Menaxhim Sistemesh Informacioni si njësi bazë kryesore ka Departamentin e Matematikë Informatikës. Njësia kryesore e disponon informacionin e nevojshëm për organizimi, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të cilat përditesohen për çdo vit akademik. Këto janë të evidentuara dhe në dokumentacionet e dorëzuara nga RVB të cilat janë plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit, kurrikulat e programit të studimit etj. Përmirësime ose ndryshime bëhen lidhur me literaturën e përdorur, raporti leksion/seminar, numri krediteve, forma e kontrollit të dijeve etj. këto ndryshime më pas arkivohen me dosjen e programit në</p>

	departament.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Programi Menaxhim Sistemesh Infomacioni si një program profesional 2 vjeçar është i orintuar drejt praktikës dhe synon zhvillimin praktik të studentëve në fushën e informatikës, teknologjive web dhe sistemeve të informacionit etj. Duke parë strukturën e programit, literaturën e përdorur dhe metodologjinë që është ndjekur për zhvillimin profesional të studenteve mund të konstatohet që ato janë të vlefshme për mbështetjen e tyre për një punësim të mëvonshëm. UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe kompani private në të cilat studentët kanë mundësi që të bëjnë praktikën dhe gjithashtu të punësohen. Në përfundim të programit të studimit MSI studentët kanë mundësi që të punësohen në këto drejtime: programues në web, studio grafike, data entry, përpunim imazhi, të punësohen si freelancer në kompani të huaja etj. Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga UBT, programi i studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni është program 2 vjeçar me kohë të plotë, i ndarë në 4 semestra dhe në total 120 kredite. Modulet e programit të studimit MSI janë të përshtatura me VKM Nr.41, Datë 24.01.2018 dhe përmbajnë informacionet të detajuara mbi ngarkesën e orëve, kreditet, rezultatet e të nxënit dhe komponentët e vlerësimit. Forma e vlerësimit është e unifikuar për të gjitha modulet duke përfshirë aktivizimin në procesin mësimor, projektet/detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare që realizohen në fund të modulit, i cili zhvillohet në fund të semestrit. Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit	UBT ka paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar që programi I studimit MSI është i hartuar në bazë të VKM Nr.41, Datë 24.01.2018. Ky program është organizuar në bazë të komponentëve të mëposhtme

<p>teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>të cilat janë të shprehura dhe në kredite.</p> <table border="1" data-bbox="600 208 1230 539"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>IAL (kredite)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>65 %</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>18 %</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese</td> <td>17 %</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse</td> <td>5 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në programin e studimit me karakter profesional praktika profesionale është pjesë përbërëse e kurrikulës dhe vlerësohet me 12 ECTS, pasqyrohet si lëndë plotësuese e karakterit D në simestrin e katërt. GVJ konstanton dhe gjate vizites që lëndët ndërdisiplinore dhe lëndet karakterizues kanë karakter të formimit praktik dhe realizohen në laboratorë.</p> <p>Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 73. Tabela 9 - Kreditet sipas veprimtarive formuese per programin MSI.pdf Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf</p>	Kategoria	Tipi	IAL (kredite)	A	Lëndë Bazë	15%	B	Lëndë karakterizuese	65 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	18 %	D	Lëndë plotësuese	17 %	E	Detyrime përmbyllëse	5 %
Kategoria	Tipi	IAL (kredite)																	
A	Lëndë Bazë	15%																	
B	Lëndë karakterizuese	65 %																	
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	18 %																	
D	Lëndë plotësuese	17 %																	
E	Detyrime përmbyllëse	5 %																	
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, për programin MSI ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese të programit të studimit është bërë duke marr parasysh kurrikulat në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, kërkesat e tregut të punës dhe duke i lejuar studentëve që të kenë mundësinë e transferimit të studimeve dhe të lëvizshmërisë në programe të ngjashme. Ndarja e krediteve në module sipas veprimtarive formuese, plani mësimor si dhe syllabuset janë përshtatur në mënyrë të tillë që tu mundësojnë studentëve formimin profesional në përputhje me tregun e punës.</p> <p>Evidenca: Dok 73. Tabela 9 - Kreditet sipas veprimtarive formuese per programin MSI.pdf Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf</p>																		
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni UBT konstantojme që për programin e studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni janë paraqitur të gjitha informacionet e nevojshme lëndore ku janë dhe syllabuset për secilin modul.</p> <p>Syllabuset e dorëzuara janë të hartuara në bazë të VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Në syllabuse përfshihen informacionet për titullin e</p>																		

	<p>modulit, titullarin e lëndës, kreditet e lëndës, simestrin dhe vitin akademik, ngarkesa në orë, cikli studimit, karakteri modulit, temat e lëndës, literatura e nevojshme dhe plotësuese etj.</p> <p>Sipas Rregullores së FEA është paraqitur që syllabuset hartohen nga titullari modulit, shqyrtohen në department, dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Në fillim të vitit akademik bëhen propozimet dhe për literaturat e reja në bibliotekë të cilat do të jenë në ndihmë të studentëve.</p> <p>Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF Dok 20. Infrastruktura akademike ne funksion te MSI.PDF</p>								
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur Institucioni UBT ka paraqitur një listë me kompani me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi dhe në kuadër të programit të studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni. Lista e kompanive është paraqitur dhe në Analizën e tregut të punës. UBT ka paraqitur që në këto institucione organizon vizita recipoke, praktika profesionale, leksione të hapura, internship-e etj. Këto praktika janë në favor të studentëve pasi i japin mundësinë që ta njohin nga afër tregun e punës dhe të integrohen sa më shpejtë. Si mundësi më e mirë është punësimi i mëvonshëm në një nga këto kompanitë.</p> <p>Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF(lista e bizneseve)</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga UBT për programin e studimit MSI konstantojmë që përmbajtja e programit të studimit garanton fitimin e dijeve, kompetencave, aftësive të synuara dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës. Studentët në përfundim të këtij programi studimi do të jenë të aftë në zgjidhjen e problemeve kryesisht në fushën e menaxhimit të sistemeve të informacionit, të teknologjive në web ose përpunim imazhi.</p> <p>Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF(lista e bizneseve)</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi Menaxhim Sistemesh Infomacioni si një program profesional 2 vjeçar është i orintuar drejt praktikës dhe synon zhvillimin praktik të studentëve në fushën e informatikës, teknologjive web dhe sistemeve të informacionit etj. Duke parë strukturën e programit, literature e përdorur dhe metodologjinë që është ndjekur për zhvillimin profesional të studentëve mund të konstantojme qe ato janë të vlefshme për mbështetjen e tyre për një punësim të mëvonshëm.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni është hapur duke marr parasysh një studim të tregut të punës duke përfshirë dhe një listë me biznese me të cilat UBT ka marrveshje bashkëpunimi. Paraprakisht është marr parasysh nevoja e tregut të punës i kompanive private dhe institucionet partnere. Në programin dhe kurrikulën e programit të studimit MSI zhvillohen lëndë të cilat i përshtaten kërkesave aktuale të tregut të punës. Gjithashtu të diplomuarit në këtë program studimi do të kenë mundësi që të kërkojnë të punësohen në disa nga drejtimet që i mundëson në përbërje programi i studimit MSI. Në dokumentacion është paraqitur një raport për trajnimet që kanë marrë studentët e FEA, gjithashtu dhe një raport i bashkëpunimeve institucionale të UBT brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF(lista e bizneseve) Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 25. Raport i Bashkepunimit Institucional brenda dhe jashte vendit, UBT.PDF Dok 27. Trajnimet e Studenteve te FEA.PDF Dok 29. Raport vleresimi, Panairi i Karrieres 2022.PDF</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur në dokumentacion që i përfshin studentët që të japin opinionet e tyre dhe në njësitë dhe strukturat e veta të vendimarrjes. Përfaqësuesit e studentëve në rang universiteti janë të përfshirë në: Senatit e UBT (3 studentë), Keshilli i Etikës UBT (1 student), komisioni i sigurimit të cilësisë së programeve të studimit dhe kërkimit shkencor (1 student). Përfshirja e studentëve në këto struktura është paraqitur dhe në statutin e UBT. Njësitë kryesore të UBT organizojne vazhdimisht diskutime me stafin akademik dhe me studentët. Në dokumentacion janë trajnimet e bëra për stafin dhe studentët.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 40. Trajnimet e Stafit te FEA-s 2015-2021.PDF Dok 27. Trajnimet e Studenteve te FEA.PDF Dok 29. Raport vleresimi, Panairi i Karrieres 2022.PDF Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 17, 18)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh,</p>	<p>Njësitë përgjegjëse për programin e studimit Menaxhim Sistemesh Informacion janë Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departamenti Matematikë Informatikës. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson dhe përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet e bëra nga rrjeti I bashkëpunimeve dhe kërkesave te tregut. Kjo fillon që nga ndryshimet që bëhen në syllabuse dhe në</p>

shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.	dojsen e programit të studimit por gjithashtu dhe në ndryshimet që mund të kërkohen të bëhen në program. Në bazë të kërkesave të tregut programi i jep studentëve mundësinë që të marrin bazat e nevojshme teorike dhe praktike që të jenë profesionist. Evidenca: Dok 27. Trajnimet e Studenteve te FEA.PDF Dok 29. Raport vleresimi, Panairi i Karrieres 2022.PDF Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF Dok 75. Tabela 12 - Plani mesimor lidhur me peroneli akademik perkates ne MSI.pdf			
Konkluzione	Programi i studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni është hapur duke marr parasysh një studim te tregut të punës duke përfshirë dhe një listë me biznese me të cilat UBT ka marrveshje bashkëpunimi. Paraprakisht është marr parasysh nevoja e tregut të punës i kompanive private dhe institucionet partnere. Në programin dhe kurrikulën e programit të studimit MSI zhvillohen lëndë të cilat i përshtaten kërkesave aktuale të tregut të punës. Njësitë përgjegjëse për programin e studimit Menaxhim Sistemesh Informacion është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departamenti Matematikë Informatikës. Njësia përgjegjëse përmireson, përditon dhe përshtat programin e studimit ne përputhje me propozimet e bëra nga rrjeti i bashkëpunimeve dhe kërkesave të tregut.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga	Institucioni UBT ka paraqitur në dokumentacionet e dorëzuara e programit të studimit Menaxhim Sistemesh Informacioni syllabuset e lëndëve, programet e lëndëve, kurrikulat etj. Modulet e programit të studimit janë të organizuara ne: leksione, seminare/ ore laboratorike, detyra/projekte dhe praktika profesionale. Syllabuset janë të ndërtuara sipas VKM Nr. 41 ku janë paraqitur të gjithë elementët e nevojshëm.

<p>institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit gjithashtu është programuar dhe praktika profesionale e cila është e vlerësuar me 18 ETSC. Praktika profesionale i ka dhënë mundësinë studentëve që të kenë njohje direkte me tregun e punës. UBT ka disa marrveshje me institucione dhe kompani private të cilat i ka paraqitur dhe në dokumentacion, në të cilat studentët mund të zgjedhin që të zhvillojnë praktikë profesionale.</p> <p>Evidenca: Dok 75. Tabela 12 - Plani mesimor lidhur me peroneli akademik perkates ne MSI.pdf Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që personeli i vetë akademik ka mundësinë e zhvillimit të mësimdhënies në mënyra të ndryshme që nga struktura që kanë modulet e programit MSI. Një nga format e mësimdhënies aktive është zhvillimi i orëve laboratorike. Të gjitha seminarët zhvillohen në laborator në formë praktike. Studentët kanë mundësi që të praktikojnë direkte njohuritë e marra në leksione. Zhvillimi i njohurive praktike merret direkte në ambientet e univesitetit nga mbështetja e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Një tjetër formë e mësimdhënies është organizimi I studenteve në grupe për zhvillimin e projekteve të cilat janë pjesë e moduleve të lëndëve. Projektet në fund të zhvillimit të tyre në shumicën e rasteve bëhen prezantime në klasa dhe studentet kanë mundësinë që të mësojnë të shprehën për një punë që kanë zhvilluar.</p> <p>Evidenca: Dok 12. Kurrikula e programit te studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 35. Plani mesimor i programit te studimit MSI (Kursi i pare dhe Kursi i dyte).pdf Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur në dokumentacioni e vetë raporte dhe përmbledhje të analizës së procesit mesimor të cilat bëhen të përvitshme. Gjithashtu institucioni ka paraqitur që i mbështet pedagogët në zhvillimin e metëjshëm duke iu ofruar mundësi e trajnimeve për stafin akademik dhe ndihmës akademik. Kjo bëhet për të përmirësuar dhe zhvilluar kompetencat didaktike dhe pedagogjike të stafit në përputhje me pritshmëritë e të nxenit në këtë program studimit por dhe në përgjigje të diversitetit dhe nevojave të studentëve. Vetë institucioni siguron një mjedis të përshtatshëm dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin shkencor dhe akademik të personelit të angazhuar në këtë program studimit. Ai ka marrveshje bashkëpunimi brenda dhe jashte vendit dhe jane paraqitur disa bashkëpunime dhe shkëmbime në kuadër të programit Erasmus+. Në fillim të vitit akademik dhe simestreve vendosen në dispozicion të zhvillimit të mësimi e gjithë infrastruktura e UBT dhe bëhet orari mesimor për</p>

	<p>perdorimin e ambienteve nga grupe të ndryshme. UBT gjithashtu ka mundësitë që ta mbështesë stafin e vetë akademik për kualifikimin e mëtejshëm për fitimin e titujve akademik dhe për zhvillimin e doktoraturave për personelin ndihmës akademik.</p> <p>Evidenca: Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF Dok 22. CV-te e stafit akademik te programit MSI.pdf Dok 26. Zyra Erasmus, UBT.PDF Dok 40. Trajnimet e Stafit te FEA-s 2015-2021.PDF</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar kemi dhe CV e stafit akademik që japin mësim në programin e studimit MSI. Personel akademik i jashtëm dhe i brendshëm është i angazhuar në fushën përkatëse, ose ka kryer dhe vazhdon të kryejë studime të metëjshme në atë fushë. UBT ka një rregullore të detajuar për rekrutimin e një stafi akademik të kualifikuar.</p> <p>UBT gjithashtu ka mundësitë që ta mbështesë stafin e vetë akademik për kualifikimin e mëtejshëm për fitimin e titujve akademik dhe për zhvillimin e doktoraturave për personelin ndihmës akademik. Kualifikimi i stafit është bërë gjithashtu duke qënë pjesë e projekteve ose grupeve kërkimore dhe mundësisë së mësimdhënies në universitete të huaja deri në periudha 1-3 mujore.</p> <p>Evidenca: Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF Dok 22. CV-te e stafit akademik te programit MSI.pdf Dok 26. Zyra Erasmus, UBT.PDF Dok 40. Trajnimet e Stafit te FEA-s 2015-2021.PDF Dok 43. Rregullore per Rekrutimin e Stafit Akademik,Ndihmes dhe Administrativ, UBT.pdf Dok 42. Rregullore per fitimin e Titujt Akademik-UBT.pdf Dok 44. Manuali i cilesise UBT.PDF Dok 24. Analiza e veprimtarise mesimore, kerkimore dhe i marredhenieve me publikun _ institucionet (FEA) 2021-.2022.PDF Dok 23. Analiza veprimtarise mesimore dhe kerkimore: , DMI 2021-2022.PDF</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që njësia përgjegjëse Departamenti Matematikë informatikës dhe personeli i vetë akademik per këtë program studimi Menaxhim sistemesh Informacioni ka vlerësuar mundësinë e zhvillimit të mësimdhënies në mënyra të ndryshme që nga struktura që kanë modulet e programit MSI. Një nga format e mësimdhënies aktive është zhvillimi i orëve laboratorike. Të gjitha seminarët zhvillohen në laborator në formë praktike. Studentët kanë mundësi që të praktikojnë direkte njohurite e marra në leksione. Zhvillimi i njohurive praktike merret direkte në ambientet e univesitetit nga mbeshtetja e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Një tjetër formë e mesimdhënies është organizimi i studentëve në grupe për zhvillimin e projekteve të cilat janë pjesë e moduleve të lëndeve. Projektet në fund të zhvillimit të tyre në</p>

	<p>shumicën e rasteve bëhen prezantime në klasa dhe studentët kanë mundësinë që të mësojnë të shprehën për një punë që kanë zhvilluar. Organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies ndiqet, monitorohet dhe kontrollohet me shume kujdes për mbarevajtjen dhe për aspektin cilësor të tij. Një nga format e vlerësimit janë dhe pyetësorët e studentëve ku studentet paraqesin opinionin e tyre në lidhje me procesin mësimor dhe sugjerimet që kanë për përmirësimin e tij. Sugjerimet e studentëve të cilat më pas konsiderohen si të vlefshme paraqiten në departament dhe me pas pasqyrohen në program.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf</p> <p>Dok 35. Plani mesimor i programit të studimit MSI (Kursi i parë dhe Kursi i dytë).pdf</p> <p>Dok 32. Syllabuset e ofruara për programin MSI.pdf</p> <p>Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF</p> <p>Dok 45. Format Pyetësi për Vlerësimin e Procesit Mesimor.PDF</p> <p>Dok 24. Analiza e veprimtarisë mesimore, kërkimore dhe i marrëdhënieve me publikun _ institucionet (FEA) 2021-2022.PDF</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësisë të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që ka njësi të veçantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtorja e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitetet e UBT. Këto janë paraqitur dhe në statutin e UBT, kreu 9, neni 83 “Organizimi Strukturor i Sigurimit të Cilësisë i UBT”. Kjo drejtori ka në përbërjen e vet Sektorin e Programeve dhe Kurrikulave dhe Sektorin e Sigurimit të cilësisë. Kjo drejtori është përgjegjëse për ndjekjen e problemeve të procesit të mësimdhënies dhe për vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Sektori i kurrikulave merret direkte me problemeve që lidhen me mësimin dhe përgatitjen e programeve të reja të studimit për të gjitha ciklet e studimit. Kurse sektori i sigurimit të cilësisë ka për detyrë të merret me përgatitjen e standarteve për hartimin e dokumentacionit që rregullon realizimin e procesit mësimor në nivel universiteti. Ky bashkëvepron me njësitë drejtuese të universitetit dhe fakultetit.</p> <p>Një tjetër njësi për kontrollin e realizimit të mësimdhënies dhe kurrikulave është zv. Dekani i FEA. Ai bashkëvepron me përgjegjësinë e departamentit për vlerësimin e cilësisë.</p> <p>Për zhvillimin e metodave të reja dhe inovative FEA organizon dhe leksione të hapura në mënyrë periodike. Një praktike tjetër është dhe zhvillimi i leksioneve nga pedagogët e huaj të cilët janë lektore të fushës. Zhvillimi i programeve Erasmus + për shkëmbimin e stafit për mësimdhënie dhe trajnim ka qënë shumë efektive gjithashtu për zhvillimin e metejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 30. Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, UBT.pdf (neni 2, 11, 15)</p> <p>Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf</p> <p>Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF (neni 13)</p>

	Dok 46. Learning agrément - Alicja Wolny Dominiak.PDF Dok 47. Learning agrément- Tomasz Wachowicz.PDF			
Konkluzione	<p>Institucioni UBT ka paraqitur në dokumentacionet e dorëzuara të programit të studimit Menaxhim Sistemes Informacioni syllabuset e lëndëve, programet e lëndëve, kurrikulat etj. Modulet e programit të studimit janë të organizuara në: leksione, seminare/ orë laboratorike, detyra/projekte dhe praktika profesionale.</p> <p>Ne programin e studimit gjithashtu është programuar dhe praktika profesionale e cila është e vlerësuar me 18 ETSC. Institucioni UBT ka paraqitur që ka njësi te vecante institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitetet e UBT.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>UBT ka paraqitur në modulet e lëndëve dhe në syllabuset e vendosura në dokumentacion për programin e studimit MSI që dy format e vlerësimit janë me anë të një provimi përfundimtar dhe me anë të vlerësimit të vazhdueshëm. Në vlerësimin e vazhdueshëm përfshihen rezultatet e kolegiumit, rezultatet e projekteve, aktivizimi në orën e mësimi. etj.</p> <p>Mënyra e vlerësimit për të gjithë modulet iu bëhet prezantim studentëve në orën e parë të mësimi dhe është e pasqyruar dhe në syllabusin përkatës të lëndës.</p> <p>Evidenca: Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>UBT ka paraqitur në modulet e lëndëve dhe në syllabuset e vendosura në dokumentacion për programin e studimit MSI që dy format e vlerësimit janë me anë të një provimi përfundimtar dhe me anë të vlerësimit të vazhdueshëm. Në vlerësimin e vazhdueshëm përfshihen rezultatet e kolegiumit, rezultatet e projekteve, aktivizimit në orën e mësimi. etj.</p> <p>Mënyra e vlerësimit për të gjithë modulet iu bëhet prezantim studentëve në orën e parë të mësimi dhe është e pasqyruar dhe në syllabusin përkatës të lëndës</p> <p>Evidenca:</p>

	Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Studentëve të programit të studimit i jepet mundësia që me anë të vlerësimit të vazhdueshëm të arrijnë të fitojnë 40% të lëndës përpara provimit përfundimtarë. Në këtë mënyrë studenti ka mundësinë që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në teori dhe në praktikë. Evidenca: Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf								
Konkluzione	UBT ka paraqitur në modulet e lëndëve dhe në syllabuset e vendosura në dokumentacion për programin e studimit MSI që dy format e vlerësimit janë me anë të një provimi përfundimtar dhe me anë të vlerësimit të vazhdueshëm. Në vlerësimin e vazhdueshëm përfshihen rezultatet e kolegiumit, rezultatet e projekteve, aktivizimit në orën e mësimit. etj. Mënyra e vlerësimit për të gjithë modulet iu bëhet prezantim studentëve në orën e parë të mësimit dhe është e pasqyruar dhe në syllabusin përkatës të lëndës.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	UBT ka paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar formën e vlerësimit që zhvillon për studentët e këtij programi. Këto të dhëna janë paraqitur në rregulloren e FEA dhe në syllabuset e lëndëve. Forma e vlerësimit ju bëhet e ditur studentëve në leksionin e parë nga pedagogu i lëndës. Pedagogu tregon formën e vlerësimit të vazhduar me të cilën studenti do të marrë gati 40% nga vlerësimi përfundimtar gjatë gjithë vitit akademik. Përcaktimi i raporteve të këtij vlerësimi bëhet nga pedagogu i lëndës, paraqitet në syllabuset e lëndëve dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit. Në këtë vlerësim të vazhduar studentët zhvillojnë një kolegium në javën e 7 ose të 8 në të cilin marrin një pjesë të pikëve. Në fund të simestrit një pjesë tjetër të pikëve studentët e marrin pasi dorëzojnë një projekt kursi, dhe nga aktivizimi në seminare/laboratore. Si përfundim pas provimit përfundimtarë pikët paraqiten në sistemin pitagora të përdorur nga universiteti. Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF (neni 55)

	Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 56. Manual Perdorimi per Sistemin Pitagora.PDF www.ubt.pitagora.rash.al
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni UBT ka paraqitur që për programin Menaxhim sistemesh të Informacionit një pjesë e lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi zhvillojnë testimin në formë elektronike. UBT ka sistemin pitagora i cili është dhe online në të cilat hidhen pikët e fituara nga studentët gjatë vlerësimit e vazhdueshem gjatë vitit akademik por dhe pikët e vlerësimit perfundimtarë. Një tjetër metodë që mund të përdorin pedagogët është dhe Clean Score në provimin e modulit. Kjo metodë ka për qëllim të zbatojë në universitet korrigjimin e automatizuar dhe të rrisi transparencën në vlerësimin e studentëve. Evidenca: Dok 32. Syllabuset e ofruara per programin MSI.pdf Dok 56. Manual Perdorimi per Sistemin Pitagora.PDF www.ubt.pitagora.rash.al
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar ne Dokumentacionin e paraqitur nga UBT, ne baze te rregullores se studimeve universitare te UBT dhe Rregullores se FEA ne komisionet e provimeve jane dy pedagoge ku njeri eshte titullari I lendes dhe tjeteri eshte asistent ose pedagogu I seminareve. Komisioni provimit dhe tezat miratohen nga pergjegjesi I departamentit. Komisioni provimeve pasi vendoset nga pergjegjesi I departamentit kalohet per miratim tek Dekani Fakultetit. Tezat jane 100 pike por konvertohen ne 60 % dhe me pas I shtohen piket e vleresimit te vazhduar. UBT realizon sekretimitn e tezave te provimit me nje fletore sekretimi dhe student e njeh dhe e vendos vete emrin ne fletoren e tij. Ne RVB eshte shprehur qe procedura e sekretimit shpesh nuk zbatohet dhe jane perdorur dhe metoda te tjera si Clean Score, kodet shifrore dhe lexues optike. Evidenca: Dok 1. RVB - MSI.pdf Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 69) Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF(neni 62)
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/fëdback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	UBT ka paraqitur që në vlerësimin e testeve bëhen komentet e nevojshme nga ana e pedagogut për të treguar mangësitë që mund të jenë lenë nga student pa plotësuar. Në këtë mënyrë dhe vlerësimi është më i qartë si për studentin dhe për stafin në rastin e rishikimit të tezës së provimit. Studenti ka të drejtë që ta rishikojë provimin e vetë nëse mendon se ka mangësi në korrigjim. Nëse student nuk është dakort me vlerësimin e marrë ai mund ta ankimojë atë dhe nëse është dakort por mendon të marr më shumë mund ta japi provimin përmirësim në vjeshtë. Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 70)
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk	UBT ka paraqitur që provimet organizohen nga komisione me

<p>lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>minimalisht 2 pedagogë dhe kjo për të shmangur çdo shkelje të rregullave dhe plagjirizmi. Vlerësimi i provimeve është një pjesë e konsiderueshme vlerësimi i vazhdueshëm e cila shmang kopjen dhe tregon originalitetin e punës së studentit. Zbatohen dhe rregullat për futjen në provimin përfundimtar që nuk lejohet të hysh pa mjet identifikimi dhe nuk lejohet përdorimi i celularëve në provim. Gjithashtu stafi akademik i harton tezat në çdo sezon provimi në disa variante.</p> <p>Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 73)</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në vizitën e bërë në UBT për programin e studimit MSI konstanton që studentët informohen për formën e studimit në orën e parë të lëndës. Gjithashtu forma vlerësimit është paraqitur dhe në syllabusin e lëndës e cili pedagogu e poston bashke me leksionet e studentëve në platformat që përdorin për shpërndarjen e materialeve. Në orën e fundit të leksioni studenti informohet për pikët që ka grumbulluar gjatë simestrin nga vlerësimi i vazhdueshëm që i është bërë për lëndën. Rezultatet e provimeve hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda 10 diteve kalendarike dhe gjenerohen nga sistemi brenda 12 ditëve duke lënë dy ditë kohë për ankimimin e studentëve.</p> <p>Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 73)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët e UBT njihen me vlerësimin e vazhdueshëm përpara se të hyjnë në provim. Vlerësimi i studentëve më pas hidhet në sistemin Pitagora bashkë me vlerësimin e provimit përfundimtar.</p> <p>Në bazë të notës së provimit dhe pikëve të marra gjatë vlerësimit të vazhdueshëm vendoset dhe nota e provimit. Nëse studentët nuk janë të kënaqur me notën e provimit mund të bëjnë rishikimin e tezës, mbasi kalon afati në sistemin pitagora atëherë nota konsiderohet përfundimtare.</p> <p>Evidenca: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 73) Dok 56. Manual Perdorimi per Sistemin Pitagora.PDF www.ubt.pitagora.rash.al</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Institucioni UBT i lejon studentit të ankimojë nëse atij i janë shkelur të drejtat gjatë vlerësimit të provimit ose nëse nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Në këtë rast mund të bëjë një ankesë me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit ose brenda 24 orëve pas marrjes së rezultatit. Ankesa shqyrtohet nga Dekani, i cili thërret përgjegjës të departamentit, komisionin e provimit si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin për zgjidhjen e saj. Nëse ankesa është e drejtë shpallet i pavlefshëm rezultati i provimit dhe caktohet një tjetër datë provimi 5 ditë nga përfundimi i sezonit.</p> <p>Evidence: Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF(neni 73)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>UBT ka paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar formën e vlerësimit</p>

	<p>që zhvillon për studentët e këtij programi. Këto të dhëna janë paraqitur në rregulloren e FEA dhe në syllabuset e lëndëve. Forma e vlerësimit ju bëhet e ditur studenteve në leksionin e parë nga pedagogu i lëndës. Pedagogu tregon formën e vlerësimit të vazhduar me të cilën student do të marrë gati 40% nga vlerësimi përfundimtar gjatë gjithë vitit akademik. Në këtë vlerësim të vazhduar studentët zhvillojnë një kolegium në javën e 7 ose të 8 në të cilin marrin një pjesë të pikëve. Në fund të simestrit një pjesë tjetër të pikëve studentët e marrin pasi dorëzojnë një projekt kursi, dhe nga aktivizimi në seminare/laboratorë. Si përfundim pas provimit përfundimtar pikët paraqiten në sistemin pitagora të përdorur nga universiteti. Institucioni UBT i lejon studentit të ankimojë nëse atij i janë shkelur të drejtat gjatë vlerësimit të provimit ose nëse nuk është dakort me vlerësimin e bërë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ka në kurrikulën e vetë lëndë të cilat i japin mundësinë studentëve që të zhvillojnë aftësitë profesionale të mëtejshme. Në bazë të kurrikulës studentët marrin fillimisht njohuritë bazë në fushën e informatikës me lëndët e formimit bazë si: hyrje në informatikë, algoritëm dhe strukturë të dhënash, sistemet e shfrytëzimit, bazat e të dhënave, programim etj. Në simestrin e tjerë njohuritë fillojnë të thellohen gradualisht në lëndë specifike në fushën e informatikës. Programi është ndërtuar në bazë të një sistemi progresiv dijesh.</p> <p>Evidenca: Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 67. Tabela 3 - Programet e studimit të ciklit I, II dhe III në FEA.pdf</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga RVB dhe vizitës në institucion, konstantojmë që programi i studimit ofron veprimtari formuese që kualifikohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndë bazë (përgatitje metodologjike dhe kulture të përgjithshme) • lëndë karakterizuese (përgatitje për disiplinën që karakterizon programin) • lëndë ndërdisiplinore (profile dhe grup lëndesh me zgjedhje)

	<ul style="list-style-type: none"> • lëndë plotësuese (gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale) • Detyrimet përmbyllëse <p>Lëndët karakterizuese përbëjnë pjesën më të madhe të programit dhe kanë më shumë kredite. Lëndët ndërdisiplinore (si Marketing, Adobe Illustrator, etj) i japin mundësi studentit që të njohë tregun e punës. Kurse lëndët plotësuese japin mundësi komunikimi për studentët.</p> <p>Evidenca: Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 67. Tabela 3 - Programet e studimit të ciklit I, II dhe III në FEA.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Institucioni UBT ka dorëzuar në dokumentacion dhe syllabuset e lëndëve të cilat janë të ndërtuara në bazë të formatit të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Objektivat e modulit pasqyrohen në syllabuse në rubrikën “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxenit”. Në përfundim të modulit stafi akademik bën një vlerësim të nivelit të përfuturit të kompetencave të synuara në syllabusin e modulit. Personeli akademik thekson çështjet e rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre si dhe për detyrime përmbyllëse. Këto diskutohen dhe në mbledhjet e departamentit dhe në analizat vjetore që bëhen në njësi.</p> <p>Evidenca: Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 67. Tabela 3 - Programet e studimit të ciklit I, II dhe III në FEA.pdf Dok 32. Syllabuset e ofruara për programin MSI.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Institucioni UBT dhe njësia e drejtëpërdrejtë për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ka paraqitur që ka një staf akademik të përshtatshëm në fushat e sistemeve të informacionit që përmban ky program në kurrikulën e vet. Studentët e MSI kanë mundësi që të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë pasi të gjithë orët e seminareve zhvillohen në laboratorë dhe mund të përfuturit dhe njohuri në praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup si në departamentin e njësisë bazë DMI dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera që japin mësim në këtë program studimi. Në dokumentacionin e paraqitur është dhe një analizë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore për Departamentin e Matematikë Informatikës.</p> <p>Evidenca: Dok 12. Kurrikula e programit të studimit MSI (2022-2023).pdf Dok 67. Tabela 3 - Programet e studimit të ciklit I, II dhe III në FEA.pdf Dok 32. Syllabuset e ofruara për programin MSI.pdf Dok 22. CV-te e stafit akademik të programit MSI.pdf Dok 23. Analiza veprimtarisë mësimore dhe kërkimore , DMI 2021-2022.PDF</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Institucioni UBT dhe njësia e drejtëpërdrejtë për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ka paraqitur që ka një staf akademik të përshtatshëm në fushat e sistemeve të informacionit që përmban ky program në kurrikulën e vet. Stafi akademik i UBT dhe i</p>

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>departamentit DMI ka zhvilluar vazhdimisht trajnime. Gjithashtu në dokumentacion janë paraqitur dhe staf i ftuar për zhvillimin e leksioneve të hapura ose trajnimeve.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 22. CV-te e stafit akademik te programit MSI.pdf</p> <p>Dok 23. Analiza veprimtarise mesimore dhe kerkimore , DMI 2021-2022.PDF</p> <p>Dok 40. Trajnimet e Stafit te FEA-s 2015-2021.PDF</p> <p>Dok 70. Tabela 6 - Stafit akademik per programin MSI.pdf</p> <p>Dok 71. Tabela 7- Stafit akademik ne MSI sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre.pdf</p> <p>Dok 21. Pedagoget e Ftuar ne FEA per Vitin Akademik 2022-2023.PDF</p>			
Konkluzione	<p>Programi i studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ka në kurrikulën e vetë lëndë të cilat i japin mundësinë studentëve që të zhvillojnë aftësitë profesionale të mëtejshme. Në bazë të kurrikulës studentët marrin fillimisht njohuritë bazë në fushën e informatikës me lëndët e formimit baze si: hyrje në informatikë, algoritëm dhe strukturë të dhënash, sistemet e shfrytëzimit, bazat e të dhënave, programim etj. Institucioni UBT dhe njësia e drejtëpërdrejtë për programin e studimit “Menaxhim sistemesh Informacioni” ka paraqitur që ka një staf akademik të përshtatshëm në fushat e sistemeve të informacionit që përmban ky program në kurrikulën e vet.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>Institucioni UBT për programin e studimit menaxhim Sistemesh Informacioni ka paraqitur në dokumentacion që si detyrim përmbyllës është provimi i formimit i cili ka 5 kredite. Institucioni i bën të njohur studentëve të vitit të dytë në fillim të vitit akademik programin e provimit të formimit nëpërmjet sekretarisë mesimore ose përgjegjës të departamentit. Këto janë shprehur dhe në rregulloren e programit të studimit MSI. Në provimin e formimit është një komision prej pesë pedagogësh. Teza hartohet në departament në bashkëpunim me pedagogët e moduleve.</p> <p>Evidenca:</p> <p>Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF</p> <p>Dok 77. Tabela 15 - Format e kontrollit te njohurive.pdf</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë	Struktura përgjegjëse e programit MSI është Departamenti i Matematikë Informatikës. DMI dhe personeli akademik që japin

<p>studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>mësim në këtë program kanë për detyrë të ndihmojnë studentët e vitit të dytë përpara provimit të formimit për pyetje dhe paqartësi në lidhje me temat që duhet të mësojnë. Gjithashtu ata vendosin në dispozicion materialet e nevojshme që duhen për përgatitjen për provimin e formimit. Këto materiale depozitohen dhe në bibliotekë dhe studentët kanë mundësi që të shkojnë ti marrin. Sekretaria mësimore është gjithashtu strukturë përgjegjëse për shpërndarjen e programit të provimit të formimit.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit të studimit MSI.PDF Dok 67. Tabela 3 - Programet e studimit të ciklit I, II dhe III në FEA.pdf Dok 77. Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur që në provimin e formimit tezat hartohen duke gërshetuar ushtrimet dhe pyetjet nga lëndë të tre profileve, formim i përgjithshëm, matematik dhe ai profesional ekonomik dhe informatikë. Studentëve në fillim të vitit të dytë akademik u vendosët një listë me pyetje nga lëndët e profilit dhe midis tyre ka lëndë karakterizuese. Kjo listë vendoset në bibliotekë në hard copy dhe në sekretari, gjithashtu dërgohet dhe nga departamenti. Provimi formimit bazohet në njohuri të marra gjatë gjithë viteve akademike.</p> <p>Institucioni UBT aktualisht për këtë program studimi MSI është në brezin e parë të të diplomuarve.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit të studimit MSI.PDF Dok 77. Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Institucioni UBT për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ka paraqitur në dokumentacion që si detyrim përmbyllës është provimi i formimit i cili ka 5 kredite. Institucioni i bën të njohur studentëve të vitit të dytë në fillim të vitit akademik programin e provimit të formimit nëpërmjet sekretaries mësimore ose përgjegjësit të departamentit. Këto janë shprekur dhe në rregulloren e program të studimit MSI.</p> <p>Institucioni ka paraqitur që në provimin e formimit tezat hartohen duke gërshetuar ushtrimet dhe pyetjet nga lëndë të tre profileve, formim i përgjithshëm, matematik dhe ai profesional ekonomik dhe informatikë. Studentëve në fillim të vitit të dytë akademik u vendosët një listë me pyetje nga lëndët e profilit dhe midis tyre ka lëndë karakterizuese.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit të studimit MSI.PDF Dok 77. Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>DMI dhe personeli akademik që japin mësim në këtë program kanë për detyrë të ndihmojnë studentët e vitit të dytë përpara provimit të formimit për pyetje dhe paqartësi në lidhje me temat që duhet të mësojnë. Gjithashtu ata vendosin në dispozicion materialet e nevojshme që duhen për përgatitjen për provimin e formimit.</p>

	<p>Stafi akademik i ndihmon studentët edhe në zhvillimin e praktikave profesionale si brenda programit të moduleve dhe temave të zgjedhura por dhe gjatë periudhës së praktikës në institucione ose në kompani. Në institucion në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi janë vendosur laboratorë për zhvillimin e seminareve dhe të punëve praktike.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 77. Tabela 15 - Format e kontrollit te njohurive.pdf Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF Dok 20. Infrastruktura akademike ne funksion te MSI.PDF</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Institucioni UBT ka paraqitur që për programin MSI në përfundim të provimit të formimit komisioni i vlerësimit është ai që jep vlerësimin përfundimtar të studentit. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo me pak se pesë anëtare te stafit akademik të propozuar nga departamenti dhe miratohen nga dekani fakultetit. Secili nga anëtarët e komisionit vendos notën e tij dhe nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë midis notave të vendosura.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF Dok 77. Tabela 15 - Format e kontrollit te njohurive.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Programi i studimit MSI akoma nuk ka nxjerrë studentë të diplomuar. Studentët e brezit të parë të këtij programi do të përfundojnë studimet këtë vit akademik. Sipas strukturës së programit dhe formës së diplomimit të UBT studentët do të pajisen me diplomën përkatëse që jepet se bashku me listën e notave të programit të studimit profesional MSI. Tërheqja e diplomës do të bëhet nga vetë i diplomuari dhe do të evidentohet në regjistrin përkatës.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në vizitën e bërë në institucion GVJ konstanton se UBT i ruan informacionet për studentët për një periudhë të pacaktuar në hard copy (që janë regjistra themeltarë të studentëve) si dhe në bazën e të dhënave që disponon UBT, sistemin Pitagora dhe sistemi EDDE3. Dokumentacionet i vihen në dispozicion studentëve me kërkesën e tij.</p> <p>Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni UBT për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ka paraqitur në dokumentacion që si detyrim përmbyllës është provimi i formimit i cili ka 5 kredite. Institucioni i bën të njohur studentëve të vitit të dytë në fillim të vitit akademik programin e provimit të formimit nepërmjet sekretarisë mësimore ose përgjegjësit të departamentit. DMI dhe personeli akademik që japin mësim në këtë program kanë për detyrë të ndihmojnë studentët e vitit të dytë përpara provimit të formimit për pyetje dhe paqartësi në lidhje</p>

	me temat që duhet të mësojnë. Gjithashtu ata vendosin në dispozicion materialet e nevojshme që duhen për përgatitjen për provimin e formimit. GVJ konstanton se duke se akoma nuk ka diplomuar në programin e studimit MSI dhe nuk ka patur akoma zhvillim të detyrimeve permbyllese.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
		X		

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni UBT ka paraqitur në dokumentacion një plan veprimi të FEA për vitin akademik 2022-2023. Ai harton në fillim të çdo viti akademik një plan veprimi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies që zbatohen në të gjitha njësitë kryesore. UBT ka udhëzues në nivel insitucional për përdorimi e metodave innovative të mësimdhënies. Ndër këto metoda mund të përmendim: E-learning që është një mënyre elektronike e të mesuarit; MOODLE i njohur si një mjedis virtual i të mesuarit; TËAL që është bibliotekë online e aplikuar në UBT; Pitagora që është një sistem i integruar për menaxhimin e vlerësimi dhe shërbimeve drejtuar studentëve. Evidenca: Dok 16. Rregullore e programit të studimit MSI.PDF Dok 56. Manual Perdorimi për Sistemin Pitagora.PDF
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni UBT ka paraqitur në dokumentacion që harton dhe zbaton strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në planin strategjik të UBT janë paraqitur strategjitë, politikat dhe procedurat për zhvillimin e mësimdhënies. Institucioni harton raporte të veprimtarive insitucionale në çdo vit akademik të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit shkencore. UBT ka paraqitur që ka njësi të veçantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitetet e UBT. Këto janë paraqitur dhe në statutin e UBT, kreu 9, neni 83 “Organizimi Strukturor i Sigurimit të Cilësisë i UBT”. Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf(neni 83) Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vlerësimit të Brendshëm dhe

	Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf Dok 48. Plan veprimi 2022-2023.PDF			
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>UBT ka paraqitur që ka njësi të veçantë institucionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë që është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E cila është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për të gjitha aktivitetet e UBT. Këto janë paraqitur dhe në statutin e UBT, kreu 9, neni 83 “Organizimi Struktural i Sigurimit të Cilësisë i UBT”.</p> <p>Kjo strukturë organizon vazhdimisht pyetësorë për vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Janë paraqitur në dokumentacion pyetësori i studentëve dhe pyetësori për pedagogët. Raportet finale të saj paraqiten në rektorat dhe më pas në department ose publikohen.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 83) Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf Dok 45. Format Pyetesori per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF</p>			
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Institucioni në mënyrë të përvitshme harton raporte të veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentet e tij dhe raportin e analizës së kërkimit. Në fakultet në fund të çdo simestri organizohet pyetësori studentor që i është kushtuar rëndësi mënyra e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Githashtu një tjetër formë është mbështetja që UBT i bën stafit akademik duke organizuar trajnime dhe mbështetur në projekte të ndryshme të cilat janë paraqitur dhe në dokumentacion.</p> <p>Evidenca: Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf (neni 83) Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf Dok 45. Format Pyetesori per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF Dok 49. Projektet e stafit FEA, 2015- 2021.PDF Dok 40. Trajnimet e Stafit te FEA-s 2015-2021.PDF</p>			
Konkluzione	<p>Institucioni UBT ka paraqitur ne dokumentacion një plan veprimi të FEA për vitin akademik 2022-2023. Ai harton në fillim të çdo viti akademik një plan veprimi për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies që zbatohen në të gjitha njësitë kryesore. UBT ka udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	--

				X
--	--	--	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënje, ku përfshihen lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që aktivizohen çdo vit, lëndët/modulet që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për çdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale.</p> <p>Aktualisht,</p> <p>Departamenti ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> - PAE (20): Prof.Dr(2), Prof.Aosoc (5), Dr (7), Dr. Proc (6) - PAK (10): Dr.(3), Dr.proc(1), Msc.(6), - Personel ndihmës: 2 , <p>i cili është në shërbim të të gjitha programeve të studimit që mbulon Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.</p> <p>Përgjegjës për organizimin e programit të studimit është Departamenti Matematikës dhe Informatikës. Përgjegjësi i departamentit mban edhe detyrën e koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca Dok 66. Tabela 2 - Staf akademik i departamentit Matematike - Informatike.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka një Rregullore të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve njerezore dhe pagave në të cilën ndërmjet të tjerave jepet edhe procedura e rekrutimit të personelit akademik. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës paraqet nevojat për personel akademik, ku vendosen kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve. Kriteret mbeten të njëjta si për staf</p>

	<p>akademik efektiv, ashtu edhe me kontratë.</p> <p>Gjate vitit akademik 2022-2023 në programin e studimit profesional dy-vjecare Menaxhim i Sistemeve te Informacionit japin mësim dymbëdhjetë PAE dhe tre PAK.</p> <p>Nga shqyrtimi i ngarkesës mesimore për vitin akademik 2022-2023 vihet re një mbingarkesë mesimore me shumë se 300 orë/vit e disa prej antareve të departamentit. Cështje e cila mund të rregullohet ose duke shtuar staf PAE ose PAK.</p> <p>[Evidenca <u>Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF</u>]</p> <p>[Evidenca <u>Dok 43. Rregullore per Rekrutimin e Stafit Akademik,Ndihmes dhe Administrativ, UBT.pdf</u>]</p> <p>[Evidenca <u>Dok 51. Rregullore e Drejtorise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore dhe Pagave.pdf</u>]</p> <p>[Evidenca <u>Dok 70. Tabela 6 - Stafi akademik per programin MSI.pdf</u>]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Departamenti i Matematikës dhe Informatikës përgjegjës për programin e studimit MSI rifreskon cdo fillim viti akademik listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjëndjen dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punësimit, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, njoftimi i vendit vakant, cv, diploma etj.</p> <p>U verifikua një praktike në të cilat ishin specifikuar përveç kriterëve të përgjithshme në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, edhe kriterë specifikë, të lidhura me fushën e ekspertizës që duhet të mbulojë personeli akademik. Nga verifikimi i cv të personelit akademik, rezultoi që në përgjithësi, personeli akademik me kohë të plotë e të pjesshme aktivizoheshin në mësimdhënie brenda fushës së tyre të ekspertizës.</p> <p>Kërkesa e departamentit përcillet nga dekanati në rektorat. Zyra e Burimeve njerëzore publikon vendet vakante në faqen e internetit si dhe në mjetet e tjera të informimit public.</p> <p>[Evidenca <u>Dok 43. Rregullore per Rekrutimin e Stafit Akademik,Ndihmes dhe Administrativ, UBT.pdf</u>]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifikë të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se pas shqyrtimit të një praktike rekrutimi të stafit akademik për programin e studimit MSI, në të ishin paraqitur kriterë të përgjithshme, si niveli i kualifikimit i kërkuar, fusha e arsimimit, eksperiencia në punë, kualifikimi shkencor.</p> <p>Në praktikën e shqyrtuar, personeli akademik i rekrutuar kishte ekspertizën në përputhje me kërkesat specifikë të shpallura. Komisioni i vlerësimit bën renditjen e kandidatëve që plotësojnë më mirë kërkesat për vendin e punës dhe ja përcjellë dekanit të fakultetit.</p> <p>[Evidenca <u>Dok 43. Rregullore per Rekrutimin e Stafit</u>]</p>

	Akademik,Ndihmes dhe Administrativ, UBT.pdf
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në ndihmë të programit të studimit MSI departamenti i Matematikës dhe Informatikës ka përveç stafit akademik dhe dy personel ndihmës akademik të cilët ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor duke siguruar mjediset laboratorike të jenë në rregull për të zhvilluar praktikat mesimore.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në zyrën e burimeve njerëzore ndodheshin të arkivuara dosjet e personelit akademik efektiv, me kontratë, ndihmës akademik. Dokumentacioni përditësohet çdo vit për çdo antarë të stafit. Cv e përditesuara të personelit janë të ngarkura në web site të universitetit. [Evidenca Dok 43. Rregullore per Rekrutimin e Stafit Akademik,Ndihmes dhe Administrativ, UBT.pdf] [Evidenca https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/]
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Programi i studimit MSI është në vitin e dytë të tij, studentet e brezit të parë janë në vitin e dytë të studimeve. Sipas programit praktika profesionale realizohen në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Sa me sipër nuk mundem që të eidentojmë konkretisht procesin e realizimit të praktikës profesionale. UBT ka 136 marrveshje bashkepunimi aktive me partnere të ndryshëm. [Evidenca Dok 69. Tabela 5- Institucionet bashkepunuese per praktikat - marreveshjet.pdf]
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Praktika profesionale për programin e studimit MSI zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Programi MSI është në vitin e dytë të tij ndaj nuk mundem dot të ekzaminonim një procedurë praktike të praktikës profesionale.
Konkluzione	Fakulteti i Ekonomise në të cilin bën pjesë programi i studimit “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit” për të realizuar

	verpimtarine e tij akademik ka personel akademik dhe ndihmës akademik që mbulon që mbulon programin e studimit, ka rregullore për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. UBT ka marrveshje bashkëpunimi me institucione për realizimin e praktikave. Programi MSI është në vitin e dytë të tij ndaj nuk mundem dot të ekzaminonim një procedurë praktike të praktikës profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Personeli akademik dhe ai administrativ ka në dispozicion ambiente të dedikuara si dhe instrumenta të nevojshëm (kompjuter, lidhje internet, kancelari, etj) për kryerjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative. Ambientet e mësim</p> <p>-dhënjes janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike. Ambientet janë të hapura dhe të aksesueshme nga i gjithë personeli akademik. Të gjitha sallat ku zhvillohen mësim janë të pajisura me video projector. Gjithashtu mësimi për lëndet e profilit informatik zhvillohet në laborator.</p> <p>[Evidenca Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF]</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se për të ndihmuar procesin mësimor lëndor është siguruar që të gjithë ambientet mësimore të jenë të pajisura me tabela, projektor dhe pc duke mundur një mesimdhënie jo vetëm teorike por dhe praktike .</p> <p>Studentëve cdo vit u kërkohet një vlerësim lidhur me përdorimin e teknologjive gjatë procesit të mësimdhënies dhe ato janë shprehur shumë pozitiv. Gjithashtu dhe nga vizita e GVJ me studentet ato u shprehen shumë pozitiv lidhur me përdorimin e teknologjive gjatë orëve mësimore (evid Dok.54).</p> <p>[Evidenca Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 54. Pyetesori OnLine i Studenteve, UBT.PDF]</p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera,	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në dispozicion të programit të studimit MSI janë laboratore të cilat e</p>

sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	drejtojnë mesimdhënien nga praktika. [Evidenca Dok 19. Infrastruktura FEA.PDF] [Evidenca Dok 54. Pyetesori OnLine i Studenteve, UBT.PDF]			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave ne UBT, GVJ konstaton se në ndihmë të mire funksionimit të programit dy vjecarë MSI janë shtatë laboratorë të cilët janë të pajisur me kompjutera të cilët disponojnë programe profesionale të cilat përdoren në lëndë të ndryshme pjesë të kurrikules se programit të studimit. [Evidenca Dok 20. Infrastruktura akademike ne funksion te MSI.PDF]			
Konkluzione	UBT ka mjedise mësimore dhe infrastrukture të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës. Në dispozicion të studenteve të programimit Menaxhim i Sistemeve të Informacionit ndodhen disa laboratore Tik dhe dia biblioteka.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave ne UBT, GVJ konstaton se cdo pedagog i vëndos në dispozicion literaturë bazë dhe ndihmëse studentëve në format elektronik ose të priturar. Materiali në formë elektronike gjendet në faqet web të pedagogëve dhe/ose në llogaritë perkatese classroom të krijuar prej tyre. [Evidenca Dok 55. Informacion nga Bibloteka Shkencore Mentor Permeti.PDF]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe infromacionii siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në dispozicion të studentevë është Bibloteka Shkencore “Mentor Permeti”, bibliotekën e Fakultetit te Ekonomisë dhe Agrobiznesit e cila është dhe online. Studentet kanë në dispozicion libraria universitare e UBT [http://www.librariaubt.com]. [Evidenca Dok 55. Informacion nga Bibloteka Shkencore Mentor]

	Permeti.PDF	
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se literatura në bibliotekën “Mentor Përmeti” mundësojnë realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore, deyrave të kursit dhe përgatitjen e tezave të diplomës. [Evidenca Dok 55. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Permeti.PDF]	
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se institucioni ka siguruar aksesin e studentëve në bibliotekat online. Ndër burimet elektronike mund të përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • Platforma JSTOR • IOPSCIENCE ASTM • EIFL [Evidenca Dok 55. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Permeti.PDF]	
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se biblioteka e UBT ka një sallë studimi me kapacitet prej 50 poste studimi. Salla e librit tekniko-shkencor “ Vasfi Samimi: kapacitet prej 35 poste studimi. Salla e librit artistik dhe periodik: kapacitet prej 40 poste studimi. Salla multimediale dhe e punës në grup” kapacitet prej 50 poste dhe 10 kompjutera në gjëndje pune ku studentet mund të studiojnë materialet e tyre si dhe të mund të punojnë në grup detyrat e kursit dhe projekte. Salla e pedagogëve dhe eventeve: kapacitet 35 poste, 6 kompjutera, printera, fotokopje etj. Për momentin dy sallat e fundit perdoren ne funksion te FBU. [Evidenca Dok 55. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Permeti.PDF]	
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte 08:00 – 16:00. Orari është i shpallur në hyrje të ambjeteve të saj.	

studentëve dhe kapacitetit të saj.	[Evidenca Vizita në bibliotekë]			
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se nuk ka shumë informacion lidhur me ndjekjen dhe raportimin e cilësisë së fondit fizik dhe elektronik të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka Shkencore u shërben rreth 908 antareve (pedagog, student, administrate etj) dhe qarkullon rreth 1607 bibliotekare materiale në vit. Frekuentimi i cdo salle evidentohet cdo ditë në evidencat përkatëse.</p> <p>[Evidenca Dok 5.5. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Permeti.PDF]</p> <p>[Evidenca Vizita në bibliotekë]</p>			
Konkluzione	<i>Programi I studimit dyjekar "Menaxhim I Sistemeve te Informacionit" ka ne dispozicion literature, biblioteka fizike dhe online. Materialiet e cdo lende gjenden ne web-et zyretare te pedagoqeve dhe ne bibliotekat e universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht
				X

Standardi IV.4			
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.			
Kriteret		Vlerësimi	
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT disponon një sistem menaxhimi të informacionit.</p> <p>Për administrimin e informacionit që lidhet me studentet institucioni përdor sistemin elektronik Pitagora i cili është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhenies dhe shërbimeve drejtuar studentëve.</p> <p>Studentet pasi regjistrohen në sekretarinë mësimore, kryejnë regjistrimin në sistemin elektronik të sekretarisë, ku pajisen me username dhe password që do ju shërbejnë për të parë të gjithë informacionin në lidhje me procesin mësimor dhe rezultatet e arritura.</p> <p>Studenti mund të monitorojë studimet e tij në universitet si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hyrjen (regjistrimin në programin përkatës të studimit) • Transferimet (lëvizjen nga një program studimi në një tjetër)_ • Faturimet, 		

	<ul style="list-style-type: none"> • Pagesat • Menaxhimin e Mësimdhënies • Klasat • Transkriptet e notave. <p>Gjatë vizitës së kryer në sekretari, u shikua regjistri themeltar, regjistri i notave disa procesverbale notash.</p> <p>Regjistri themeltar ishte i plotësuar.</p> <p>Nuk u gjetën parregullsi në hedhjen e rezultateve të studentëve nga procesverbalet në regjistrin themeltar.</p> <p>Dosjet e studenteve ishin te plota.</p> <p>Dosjet e transferimit te studenteve ishin te plota.</p> <p>[Evidenca www.pitagora.rash.al]</p> <p>[Evidenca vizite ne sekretarine mesimore]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT administron informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e procesit mësimor nëpërmjet një sistemi të brendshëm i cili menaxhohet nga Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Informacioni dhe dokumentacioni lidhur me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative mbahet nga zyra e burimeve njerëzore . Informacioni mbahet në dosje në format hard copy.</p> <p>Në takimin e bërë me zyrën e burimeve njerëze u verifikua dosja e një personeli akademik efektiv.</p> <p>Dosja ishte e plotë, me të gjithë informacionet dhe të dhënat per personelin: CV, ID, Diplomat dhe Kualifikimet, librezë shëndetësore, Raport Mjeko-Ligjor, Librezë pune, kontrata e angazhimit.</p> <p>[Evidenca Dok 30. Rregullore e Drejtorise se Vleresimit te Brendshem dhe Sigurimit te Cilesise, UBT.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT disponon nje iIstem menaxhimi të studenteve i cili ofron informacion të dedikuar pasi cdo student ka llogarine e tij personale në sistemin pitagora.</p> <p>Informacioni lidhur me personelin ndodhet ne faqen web te universitetit dhe është i aksesueshëm nga të gjithë.</p> <p>[Evidenca www.pitagora.rash.al]</p> <p>[Evidenca https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/]</p> <p>[Evidenca Dok 56. Manual Perdorimi per Sistemin Pitagora.PDF]</p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se sistemi elektronik pitagora mundëson një komunikim efikas ndërmjet pedagogeve, studentëve dhe sekretarisë.</p> <p>Në profilet zyrtare në webin e UBT ndodhen dhe adresat e email të stafit akademik.</p> <p>Gjithashtu që pas pandemisë Covid 2019, komunikimi ndërmjet pedagogeve dhe studenteve është realizuar edhe nëpërmjet klasave virtuale të ngritura në platformen google classroom.</p> <p>[Evidenca www.pitagora.rash.al]</p> <p>[Evidenca https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/]</p>								
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se realizohen anketa nëpërmjet të cilave studentet cdo fund semestri vlerësojnë performacën e pedagogeve.</p> <p>Sistemi i menaxhimit siguron monitorimin e mësimdhënjes dhe të realizimit të aktiviteteve të tjera formuese edhe gjatë zhvillimit të mësimin në auditor apo gjate procesit të kryerjes së praktikave dhe punimeve të diplomave.</p> <p>[Evidenca Dok 24. Analiza e veprimtarisë mesimore, kërkimore dhe i marredhenieve me publikun institucionet (FEA) 2021-2022.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 45. Format Pyetesori per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF]</p>								
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT ka një faqe zyrtare web në të cilën gjenden informacione për universitetin, programet e studimit, kurrikulat e cdo program studimi, personelin akademik dhe jo akademik, kërkimin shkencor etj.</p> <p>[Evidenca https://ubt.edu.al]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>Fakuleti i Ekonomisë, ku bën pjesë programi i studimit “Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit” disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p> <p>Studentet kanë sistemin e tyre pitagora në të cilin marrin informacione me kurrikulen, orarin, notat etj.</p> <p>Informacioni lidhur me personelin ndodhet në faqen web të universitetit dhe është i aksesueshëm nga të gjithë.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1713 807 1805">Përmbushet</th> <th data-bbox="807 1713 1002 1805">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1002 1713 1187 1805">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1187 1713 1374 1805">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1805 807 1854"></td> <td data-bbox="807 1805 1002 1854"></td> <td data-bbox="1002 1805 1187 1854"></td> <td data-bbox="1187 1805 1374 1854">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se departamenti i Matematikë – Informatikë ku bën pjesë programi i studimit MSI ka të drejtën e tij ligjore për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të realizimit të programeve të studimit që ofrohen .</p> <p>Pjesë e procesit të analizimit të gjendjes financiare është edhe llogaritja e kostos totale për student si dhe kosto për student ndarë sipas programeve të studimit. Në raportin e kosto përfaqësohen, koston e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, koston e tjera operacionale, koston për pajisje të cilat përfaqësojnë koston për krijimin , kompletimin dhe rinovimin e laboratoreve etj.</p> <p>Institucioni harton një raport financiar të kostove mesatare të programit të studimit, ku kosto për student është 114152.65 lekë. Financimi për student bëhet nga grant i shtetit në bazë të ligjit të Arsimit të lartë 80/2015. Financimi i grantit është miratur nga IAL dhe bëhet nga Ministria e Arsimit.</p> <p>Gjithashtu vlen të theksohet se nga ana e institucionit krahas analizimit të kostove janë studiuar dhe identifikuar dhe burimet e gjenerimit të të ardhurave me të cilat do të mbulohen koston duke synuar rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe kapaciteteve të universitetit.</p> <p>[Evidenca Dok 37. Tarifa, kriteret e pranimit dhe modalitetet financiare per studentet e MSI.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 52. Relacion per realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022.PDF]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit,</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Universiteti periodikisht llogarit dhe studion koston e programeve dhe studion e vlerëson mënyrat e financimit të koston. Nga relacioni për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimin për 2022, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, i përballon shpenzimet e parshkuara për pagat, investimet, mallrat dhe shërbimet. Institucioni në planin strategjik të universitetit për periudhën 2016-2025, parashikon planin strategjik për zhvillimin e programit në nivel akademi, financiar , burimesh njerëzore etj.</p> <p>[Evidenca Dok 52. Relacion per realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 17. Plani Strategjik i UBT-se 2016-2025.pdf]</p>

projektet dhe zëra të tjerë.	
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se zyra e financës harton dhe i paraqet bordit të administrimit raporte që kanë të bëjnë me buxhetin e flukseve monetare. Cdo vit raporti i pasqyrave financiare vjetore i nënshtrohet kontrollit sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilizimit.</p> <p>Institucioni kryen auditime të përvitshme, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> <p>Kontrolli dhe auditimi i jashtëm kryhet nga auditës të brëndëshëm ose të jashtëm, të cilët përzgjidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar cdo vit nga Ministria e Financave.</p> <p>Gjithashtu auditimi kryhet dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).</p> <p>[Evidenca Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se analizat financiare dhe raportet, raportohen në rektorat, senatin akademik, dhe miratimi përfundimtar bëhet në bordin e administrimit.</p> <p>[Evidenca Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se 70 % e financimit institucional realizohet nga qeveria dhe mbi 30 % nga të ardhurat e UBT-së. Të ardhurat e universitetit sigurohen nga tarifatat dhe shërbimet për studentet, nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, qendra eksperimentale, qera ambjentesh etj.</p> <p>[Evidenca Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Departamenti i Matematikë – Informatikë ku bën pjesë programi i studimit MSI ka të drejtën e tij ligjore për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të realizimit të programeve të studimit që ofrohen .</p> <p>Gjithashtu vlen të theksohet se nga ana e institucionit krahas analizimit të kostove janë studiuar dhe identifikuar dhe burimet e gjenerimit të të ardhurave me të cilat do të mbulohen kostot duke synuar rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe kapaciteteve të universitetit.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, i përballon shpenzimet e parshikuara për pagat, investimet, mallrat dhe shërbimet. Institucioni në planin strategjik të universitetit për periudhën 2016-2025, parashikon planin strategjik për zhvillimin e programit në nivel</p>

	akademi, financiar , burimesh njerëzore etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Institucioni në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore, zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundur ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Këto politika dhe procedura shprehen në planin strategjik të universitetit, Statutin e Universitetit, Rregulloret e UBT, Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe Rregulloren e Programit të Studimit dyvjeçar Menaxhim Sistemesh Informacioni.</p> <p>[Evidenca Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf] [Evidenca Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF] [Evidenca Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF] [Evidenca Dok 16. Rregullore e programit të studimit MSI.PDF]</p>
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se programi i studimit dy vjeçar “Menaxhim Sistesh Informacioni” mund të ndiqet nga cdo shtetas shqiptarë, shqiptarë etnik jashtë kufijve shtetërore si dhe cdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuara. UBT krijon mundësi komunikimi me ambjentin e jashtëm nëpërmjet webit zyrtarë, ditëve të informimit. Etj.</p> <p>[Evidenca Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF]</p>

	[Evidenca Dok 57. Ditet e Informimit te Maturanteve, Shkurt-Qershor 2022.PDF]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se cdo vit akademik senati akademik UBT I propozon MAS kriteret e pranimit të apikanteve për të studiuar ne UBT. Cdo vit zyra e karrieres së Studenteve prane FEA pregadit paketën informuese për aplikantet e intresuar për të vijuar studimet e tyre në progamin DMI. Ky informacion u vihet në dispozicion maturanteve në ditet e informimit, gjithashtu gjendet dhe në faqen web te ubt.</p> <p>[Evidenca Dok 57. Ditet e Informimit te Maturanteve, Shkurt-Qershor 2022.PDF]</p> <p>[Evidenca https://www.ubt-uni.net/sq/studimi/programet-bachelor/shkenca-te-ushqimit-dhe-teknologji/pranimi-ne-studime-kriteret-deadlines/]</p>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se pregaditen paketa informuese për të gjithë kandidatet e interesuar për të vijuar studimet e tyre në MSI.</p> <p>Informacioni është i publikuar në webin zyrtarë të UBT.</p> <p>Rregullorja e studimeve universitare si dhe ne regulloren e programit te studimit MSI përshkruhen në mënyre të qartë procedurat për organizimin dhe ndërprerjen e studimevem përparimin e studenteve gjatë kuresit, të transferimti, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit.</p> <p>[Evidenca Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF]</p>
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se përpara cdo viti në faqen web, portalin U-Albania dhe jo vetem shfaqen informacion lidhur me kritret e vecanta në lidhje me kandidatet e interesuar për të aplikuar në MSI, gjithashtu një vend i posatcëm në dispzicion në këto dritare informimi u kushtohet dhe kandidateve me aftesi te vecanta, pakicave dhe shtresa të marginalizuara.</p> <p>[Evidenca Dok 34. Lista e studenteve te regjistruar me kuotat sipas kategori ve te vecanta.PDF]</p>
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se harton cdo vit procedurë përkatëse për përjashtin e studenteve nga tarifa e shkollimit dhe studentet të cilët përfitojnë bursë. Njoftimi vendoset ne webin e UBT.</p> <p>[Evidenca Dok 63. Njoftim per Studentet per Perfitimin e Burses per</p>

	<p>Vitin Akademik 2022-2023.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 64. Njoftim per Studentet per Perjashtimin nga Tarifa per Vitin Akademik 2022-2023.PDF]</p>			
Konkluzione	<p>Cdo vit akademit senati akademik UBT I propozon MAS kriteret e pranimit të apikanteve për të studiuar ne UBT. Cdo vit zyra e karrieres së Studenteve prane FEA pregadit paketën informuese për aplikantet e intresuar për të vijuar studimet e tyre në progamin DMI. Ky informacion u vihet në dispozicion maturanteve në ditet e informimit, gjithashtu gjendet dhe në faqen web te ubt.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe infromacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT vë në dispozicion (në faqen zyrtare web) rregulloren e studimeve universitare, rregulloren e FEA, Rregulloren e ZSS, rregulloren e programit të studimit MSI të cilat përmbajnë informacion të plotë lidhur me procedurat e përparimit akademik te studenteve, kohëzgjatjes së studimeve dhe kushteve të kalimit në vitin pasardhes.</p> <p>Gjithashtu cdo vit të ri akademik, pedagogu I lëndes afishin ne webin e tij programin e lëndës që ligjeron.</p> <p>Cdo vit akademik me studentet e vitit të pare organizohet nje takim informues me qëllim informimin e tyre lidhur me kriteret dhe procedurat e perparimit akademik, kalimit nga nje vit ne tjetrin.</p> <p>[Evidenca Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF]</p> <p>[Evidenca https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemenager/]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe infromacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT ve ne dispozicion (ne faqen zyrtare web) informacion lidhur me njohjen dhe transferimin e krediteve te studimeve, midis programeve tte të njejtit cikël, brenda vetë UBT dhe universitete te tjera.</p> <p>[Evidenca Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF]</p>

	[Evidenca Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se studentet njihen në mënyrë të vazhdueshme lidhur me të gjithë elementët që kanë të bëjnë me vlerësimin e tyre. Këto informacione gjenden në rregulloren e FEA-së, rregulloren e Programit të Studimit, gjithashtu cdo fillim semestri pedagogu informon studentitn lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Rezultatet e provimeve studentet mund ti aksesojnë në llogaritë e tyre personale në sistemin pitagora.</p> <p>[Evidenca Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF]</p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në përfundim të kursit të plotë të studimeve vlerësohen me provim diplomimi. Kriteret dhe procedurat janë të shpalosurara qarte në rregulloren e programit te studimit, gjithashtu shpallen dhe në sekretarinë mësimore.</p> <p>[Evidenca Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF]</p>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në faqen web të UBT është e afishuar kurrrikula e programit te studimit dyvjecar MSI. Organizohen ditet informuese për maturantet dhe kandidatet e interesuar për të aplikuar në programin e studimit MSI.</p> <p>Informacion lidhr me kuotat, kriteret e pranimit etj, janë të publikura në portalin U-Albania.</p> <p>Në ambjentet e kampusit janë të vendosur banera me informacione rreth programit të studimit.</p> <p>Zyra e karrieres së studenteve nga ana e saj luan nje rol të vecante lidhur me orientimin dhe informimin e të interesuarve për të vijuar studimet ne DMI.</p> <p>[Evidenca Dok 57. Ditet e Informimit te Maturanteve. Shkurt-Qershor 2022.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 60. Flete Palosje FEA.PDF]</p> <p>[Evidenca https://ualbania.arsimi.gov.al/FushaDege/Index]</p>
Konkluzione	<p>UBT vë në dispozicion (në faqen zyrtare web) rregulloren e studimeve universitare, rregulloren e FEA, Rregulloren e ZSS, rregulloren e programit të studimit MSI të cilat përmbajnë informacion të plotë lidhur me procedurat e përparimit akademik te</p>

	<p>studenteve, kohëzgjatjes së studimeve dhe kushteve të kalimit në vitin pasardhës.</p> <p>Gjithashtu cdo vit të ri akademik, pedagogu I lëndës afishin ne webin e tij programin e lëndës që ligjeron.</p> <p>Cdo vit akademik me studentet e vitit të pare organizohet nje takim informues me qëllim informimin e tyre lidhur me kriteret dhe procedurat e perparimit akademik, kalimit nga nje vit ne tjetrin.</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit dy vjeçarë MS, rregulloren e studimeve universitare parashikohet në mënyrë të detajuar struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e studimeve.</p> <p>Informacion ky pasqyrohet në faqen web të UBT, në tabelat e njoftimeve.</p> <p>Cdo vit akademik drejtuesi i njesisë bazë dhe stafi akademik organizojnë takime informuese me studentet e vitit të parë, lidhur me vijueshmërinë e studimeve të tyre dhe mundësinë e zhvillimit të karrieres.</p> <p>[Evidenca Dok 16. Rregullore e programit te studimit MSI.PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 14. Rregullore e studimeve universitare.PDF]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në webin e UBT-së është publik informacioni lidhur me programin e studimit dyvjeçar MSI. Gjithashtu në website-et e pedagoqeve gjendet i detajuar informacion lidhur me sylabusin, kreditet, raportin e oreve etj.</p> <p>Gjithashtu studentet e interesuar mund të drejtohen në sekretarinë mesimore dhe/ose laborantët/specialistët për të siguruar informacion lidhur me këtë çështje.</p> <p>[Evidenca www.ubt.edu.al]</p>

	[Evidenca https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/]			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në kuader të strukturës organizative të UBT, është ngritur qendra e karrieres dhe Alumni, qëllimi kryesor i së cilës është mbështja dhe orientimi i studenteve drejte tregut te punes.</p> <p>Megjithatë, programi i studimit, MSI është në vitin e dytë të tij, ndaj informacioni faktik lidhur me këtë pikë është i vakët.</p> <p>[Evidenca Dok 59. Skede Punesimi.PDF]</p>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambientet e Universitetit, në sekretarinë online dhe në faqen e tij web, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se njësi bazë nëpërmjet koordinimit me QKA, siguron që praktika profesionale në kuader të realizimit të programit të studimit të kryhet në institucionet me të cilat universiteti ka bashkepunime.</p> <p>Cdo vit në ambejntet e UBT zhvillohet panairi i karrieres, njësi bazë nxit studentet të marrin pjesë në panair në funksion të përafritit të ofertës dhe kërkeses për punësim.</p> <p>Duke qënë qe cikli i pare akoma nuk e ka përfunduar programin , nuk ka statistika dhe informacione lidhur me përmushjen e kësaj pike.</p> <p>[Evidenca Dok 18. Analiza e tregut te punes (MSI).PDF]</p> <p>[Evidenca Dok 69. Tabela 5- Institucionet bashkepunuese per praktikat - marreveshjet.pdf]</p>			
Konkluzione	<p>Cdo vit akademik drejtuesi i njesisë bazë dhe stafi akademik organizojnë takime informuese me studentet e vitit të parë, lidhur me vijueshmërinë e studimeve të tyre dhe mundësinë e zhvillimit të karrieres.</p> <p>Ne website-et e pedagoqeve gjendet i detajuar informacion lidhur me sylabusin, kreditet, raportin e oreve etj.</p> <p>Gjithashtu studentet e interesuar mund të drejtohen në sekretarinë mesimore dhe/ose laborantet/specialistet për të siguruar informacion lidhur me këtë çështje.</p>			
Shkalla e përmushjes së standardit	Përmushet pjesërisht	Përmushet kryesisht	Përmushet plotësisht	
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se zyra e informacionit dhe statistikave në bashkëpunim me zyrën e studimeve dhe studenteve grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna në lidhje me regjistrimet, rezultatet e provimeve, grupmoshat, tërheqjet nga programi etj.</p> <p>Informacion në lidhje me diplomimin nuk ka akoma pasi ende nuk është diplomuar brezi i parë i studenteve.</p> <p>Megjithatë stafi i lartepërmendur është i gatshëm për të realizuar dhe përpunim të dhënash lidhur me diplomimet e para që pritet të kryhen këtë vit akademik.</p> <p>[Evidenca Dok 30. Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilesisë, UBT.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigura dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se UBT ka struktura të vecanta për dixhitalizimin e të dhënave, për ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike për mbledhjen e të dhënave statistikore.</p> <p>Nepernjë sistemit të menaxhimit të informacionit Pitagora, ruhen ndër vite të dhënat për çdo student nga të cilat mund të gjenerohen informacione të ndryshme sipas kërkesave.</p> <p>UBT disponon bazë të dhënash në lidhje me regjistrimin e studenteve.</p> <p>UBT disponon regjistrat bazë të studenteve (në formë të shkruar dhe elektronik) me vleresimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit.</p> <p>[Evidenca Dok 56. Manual Perdorimi per Sistemin Pitagora.PDF]</p> <p>[Evidenca Vizita ne Sekretarine Mesimore]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studenteve ruhen në zyrën e studenteve dhe studimeve në formë hard copy dhe elektronike.</p>

që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.									
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se nga ana e zyres së Informacionit dhe Statistikes dhe zyres së studimeve dhe studenteve grumbullohen informacione lidhur me regjistrimet/aplikimet, mesataret e aplikanteve, rezultatet e provimeve etj.</p> <p>Zyra e karrierës së Studenteve është përgjegjëse për mbajtjen e evidencave lidhur me fazën e përfundimit të studimeve. Por duke qenë se brezi i parë i studenteve të cilët ndjekin programin e studimit MSI nuk është diplomuar ende, nuk ka të dhëna ende.</p>								
Konkluzione	<p>Zyra e informacionit dhe statistikave në bashkëpunim me zyrën e studimeve dhe studenteve grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna në lidhje me regjistrimet, rezultatet e provimeve, grupmoshat, tërheqjet nga programi etj.</p> <p>Informacioni në lidhje me diplomimin nuk ka akoma pasi ende nuk është diplomuar brezi i parë i studenteve.</p> <p>Zyra e karrierës së Studenteve është përgjegjëse për mbajtjen e evidencave lidhur me fazën e përfundimit të studimeve. Por duke qenë se brezi i parë i studenteve të cilët ndjekin programin e studimit MSI nuk është diplomuar ende, nuk ka të dhëna ende.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se mbështetur në statutin e UBT parashikohet përfshirja e studenteve në organet vendimmarrëse e këshilluese.</p> <p>Studentet kanë të drejtë të zgjedhin Rektorin, dekanin e njesisë kryesore etj, të zgjedhin dhe zgjidhen si pjesë përbërë e senatit akademik në masën 10%. Ka këshilla studentor në rang fakulteti.</p> <p>Nuk ka informacion në RVB as gjatë vizites nuk u bë me dije nëse studentet e programit MSI janë të angazhuar në vendimmarrje.</p>

	[Evidenca Dok 13. Statuti i UBT-se.pdf]			
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se nga takimi me studentet, doli që organizimet studentore funksiononin dhe nëpërmjet tyre studentët përcillnin zërin dhe shqetësimet e tyre në organet drejtuese të universitetit, departament, fakultet, senatin akademik. [Evidenca Takimi me Studentet]			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se në fund të cdo semestri apo para sezonit të provimeve, Fakulteti dhe njësia bazë organizojnë pyetsorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e cdo programi studimi. Nëpërmjet këtij pyetsori studentet kanë mundësinë të shprehin opinione, qëndrime, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. [Evidenca Dok 45. Format Pyetesori per Vleresimin e Procesit Mesimor.PDF]			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se pedagogu i modulit i komunikon studentit te drejten per tu futur ose jo ne provimin final dhe nivelin e pikeve te marra ne oren e fundit te mesimit. Pas shpalljes se rezultateve dhe hedhjes ne systemin pitagora student ka te derjte te kundershtoj rezultatin brenda 48 oreve. Komisioni duhet te sqaroj studentetin ne lidhje me vleresimin. Ne rast hedhjes se notes se gabuar nga ana e komisionit ai ka detyrimin të bej korigjimin e saj brenda 12 ditesh. Studenti ka të drejtë të ankimoj nese ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjate zhvillimit të provimit ose nuk është dakort me vlerësimin e bëre. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së provimit ose brenda 48 oreve pas shpalljes se rezultatit dhe i drejtohet dekanit të FEA. [Evidenca Dok 15. Rregullore FEA-s 2017.PDF]			
Konkluzione	Në statutin e UBT parashikohet përfshirja e studenteve në organet vendimarrëse e këshilluese. Fakulteti dhe njësia bazë organizojnë pyetsorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e cdo programi studimi. Nëpërmjet këtij pyetsori studentet kanë mundësinë të shprehin opinione, qëndrime, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashiki me ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se me vendim te senatit nr 14 dtate 28.12.2013 është ngritur qendra e karrieres dhe studimeve e cila ka për qëllim kryesor mbështjetjn dhe orjetimin e stentece lidhur me karrieren.</p> <p>Zyra e Studimeve dhe Studenteve ka si qëllim ofrimin e shërbimeve dhe informacioneve për studentet e UBT.</p> <p>Struktura drejtuese e UBT dhe njësa kryesore si pjesë e njësisë bazë janë në menyre të vazdhueshm në shërbim të studentëve.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturanëve mbi programet e studimit të ofruara dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Qendres së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët. Nga takimi me studentet, doli që ndihma e pedagogeve nëpërmjet konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte e madhe.</p> <p>[Evidenca https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve]</p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se QKA informon vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat institucioni bashkëpunon.</p> <p>Praktikat mësimore zhvillohen në institucionet me të cilat “UBT” ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>[Evidenca Dok 69, Tabela 5- Institucionet bashkepunuese per praktikat - marreveshjet.pdf]</p>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i siguruar gjatë vizitave në UBT, GVJ konstaton se brezi i pare i studenteve qe ndjekin studimet ne profilin MSI nuk eshte diplomuar akoma, ndaj nuk ka informacion.</p>

dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse					
Konkluzione	<p>Qendra e karrieres dhe studimeve e cila ka për qëllim kryesor mbështjetjn dhe orjetimin e stentece lidhur me karrieren.</p> <p>Zyra e Studimeve dhe Studenteve ka si qëllim ofrimin e shërbimeve dhe informacioneve për studertet e UBT.</p> <p>Struktura drejtuese e UBT dhe njësa kryesore si pjesë e njësisë bazë janë në menyre të vazdhueshm në shërbim të studentëve.</p> <p>Qendres së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët. Nga takimi me studentet, doli që ndihma e pedagogeve nëpërmjet konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte e madhe.</p>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional ne “Menaxhim Sistemesh Informacioni” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor Tiranë”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës është një nga institucionet e arsimit të larte publikë dhe me përvojë të gjerë në tregun e punës në drejtimet e studimit që ofron.
2. Intitucioni UBT disponon mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
3. Intitucioni UBT ka një staf akademik me eksperiencë për këtë program studimi. Stafit akademik i përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi është profesionist dhe me tituj. Gjithashtu mund të japin një përvojë të madhe për studentët e këtij programi studimi.
4. UBT ofron për këtë program studimi një kurrikul të pasur me module të programeve të cilat janë bashkëkohore dhe të kërkuara nga tregu i punës. Këto module që janë zgjedhur për programin e studimit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” i japin njohuritë bazë teorike dhe praktikë për të këkuar punë në profil direkte pas ndjekës së këtij programi.
5. Institucioni UBT mbështet zhvillimin e stafit akademik dhe të përmirësimit të vazhdueshëm, ka zhvilluar mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik;
6. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UBT dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
7. Programi i studimit që ofron UBT megjithësi është në fushën e teknologjisë së Informacionit është i orientuar në bazat e studimit në zbatimin e vet në fushën e ekonomisë dhe kjo krijon perparësi dhe për studentët ne mundësitë e punësimit.
8. Kujdesi ndaj studentit realizohet në plotësim të të gjitha kushteve kontraktuale;
9. Sistemi funksional elektronik të menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit të brendshëm të institucionit, por dhe të gjithë aktivitetit didaktik.


Pika të dobta

1. GVJ konstanton qe për programin “Menaxhim Sistemesh Informacioni” nuk ka patur përfshirje të studentëve te programit MSI në projekte ose mobilitete ndërkombetare Erasmus+.
2. GVJ konstanton që institucioni nuk ka marrveshje bashkëpunimi me shume kompani që operojne ne fushën e teknologjisë së informacionit ku studentët e MSI mund të merrnin njohuri të mirefillta në praktikatat e tyre.

3. Zyra e karrierës së Studenteve është përgjegjëse për mbajtjen e evidencave lidhur me fazën e përfundimit të studimeve. Por duke qenë se brezi i parë i studenteve të cilët ndjekin programin e studimit MSI nuk është diplomuar ende, nuk ka të dhëna ende.
4. Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit. Mungesë e teksteve fizike për literaturën bazë dhe të rekomanduar në bibliotekë për programin e studimit.
5. GVJ konstantoi se për programin MSI është në vitin e dytë të tij ndaj nuk mundem dot të ekzaminonim një procedurë praktike të praktikës profesionale dhe të detyrimeve permbyllese të provimit të formimit.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që shikohet mundësia për bashkëpunime me institucione të tjera ndërkombëtare që kanë programe studimi të ngjashme që kanë projekte në Erasmuss+ ose të tjera dhe të përfshihen dhe studentët e profilit “Menaxhim Sistemesh Informacioni” në UBT.
2. GVJ rekomandon që IAL të këtë me shumë marrveshje bashkëpunimi me kompani që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit në mënyrë që studentët të kenë mundësi praktike më të mira.
3. Institucioni të përditësojë literaturën e detyrueshme dhe specifike për të gjitha lëndët e programit të studimit dhe të vazhdojë pasurimi i literaturës fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve;
4. Institucioni të konsolidojë mjediset profesionale ku studentët kryejnë praktikën e nevojshme në lidhje me programin e studimit;
5. GVJ rekomandon që akreditimi i programit të studimit MSI (sic është rekomanduar dhe nga GVB) të ishte bërë në përfundim të vitit akademik 2022-2023 për të patur evidence konkrete lidhur me praktikën profesionale të studenteve, diplomimin, punësimin etj.



Evaluation's conclusions for the professional study program " Information Systems Management " provided by the Higher Education Institution " Tirana Agricultural University"

Strengths and affirmations

1. The Agricultural University of Tirana is one of the public higher education institutions with extensive experience in the labor market in the fields of study it offers.
2. The UBT institution has suitable facilities and the modern didactic infrastructure available for the study program offers the necessary contemporary spaces and conditions for the learning process;
3. The UBT institution has an experienced academic staff for this study program. The academic staff involved in teaching in this study program are professional and qualified. They can also provide a great experience for the students of this study program.
4. UBT offers for this study program a rich curriculum with program modules which are contemporary and required by the labor market. These modules that have been chosen for the study program "Management of Information Systems" provide the basic theoretical and practical knowledge to look for a job in a direct profile after following this program.
5. The UBT institution supports the development of academic staff and continuous improvement, has developed specific mechanisms for the support and professional qualification of academic staff;
6. The study program is designed in accordance with the development strategy of UBT and the economic development of the country and meets the needs of the labor market, in accordance with the strategic goals of national economic development.
7. The study program offered by UBT, although it is in the field of Information technology, is oriented to the basics of the study in its application in the field of economy, and this creates advantages for students in terms of employment opportunities.
8. Student care is carried out in compliance with all contractual conditions;
9. The functional electronic system of information management in function of the internal administration of the institution, but also of the entire didactic activity.


Weaknesses

1. GVJ confirms that for the "Information Systems Management" program, there has been no involvement of students of the MSI program in Erasmus+ international projects or mobilities.
2. GVJ confirms that the institution does not have cooperation agreements with many companies operating in the field of information technology where MSI students could get real knowledge in their practices.
3. The Student Career Office is responsible for keeping records related to the phase of completing studies. But since the first generation of students who follow the MSI study program has not yet graduated, there is no data yet.
4. The mandatory literature of the study program, in some courses is not of the last 5 years. The lack of physical texts for basic and recommended literature in libraries for the study program.

5. GVJ confirmed that the MSI program is in its second year, so we could not examine a practical procedure of the professional practice and the final obligations of the diploma exam.

Recommendation

1. GVJ recommends looking at the possibility of cooperation with other international institutions that have similar study programs that have projects in Erasmus+ or others and to include the students of the "Information Systems Management" profile at UBT.
2. GVJ recommends that HEIs do this with many cooperation agreements with companies that operate in the field of information technology so that students have better practical opportunities.
3. The institution should update the mandatory and specific literature for all subjects of the study program and continue the enrichment of physical literature for the subjects of the study program in accordance with the updated subject programs;
4. The institution should consolidate professional environments where students perform the necessary practices related to the study program;
5. 5. GVJ recommends that the accreditation of the MSI study program (as also recommended by GVB) was done at the end of the academic year 2022-2023 in order to have concrete evidence regarding the professional practices of students, graduation, employment, etc.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X